

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Kualifikimin Profesional

FERMA BUJQËSORE DHE BLEGTORALE

Niveli III i KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²
(1 vjeçar)

Kodi: H2-III-25

(Hartuar me mbështetjen e Projektit ProSEED 2.0 - GIZ)

Miratoi:

MINISTRI

1.Korniza Shqiptare e Kualifikimit
2.Korniza Europiane e Kualifikimit

Tiranë, 2025

Përmbajtja:

I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK.

1. Kërkesat e pranimi të nxënësve në arsimin profesional në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK.
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK.
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK.
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK.

III. Plan i mësimor për kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK.

IV. Udhëzime për planin mësimor

V. Udhëzime për procesin mësimor.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK,

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.

XI. Programi orientues i provimeve përfundimtare të nivelit.

I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale, niveli III i KSHK, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me fermat bujqësore dhe blegtorale.* Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtijshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me përpikmëri;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale” niveli III i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në kualifikimin profesional “Bujqësi”, niveli II i KSHK;
- janë të aftë të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitet reale të këtyre shkollave, atëherë, Ministria përgjegjëse e AFP-së përgatit udhëzime të veçanta me kriteret e posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integritimeve lokale, rajonale;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
- Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
- Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
- Të pranojë dhe të promovojë rrisht dhe ndryshimet;
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij, për t'u përshtatur me evolucionin teknologjik.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin I-rë dhe të II-të të KSHKI, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të bëjë planifikimin, organizimin e vogël të punës dhe menaxhimin e burimeve të nevojshme për realizimin e punës në fermat bujqësore e blegtorale.
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacionin teknik të profesionit.
- Të zbatojë standardet e profesionit gjatë menaxhimit të fermave bujqësore e blegtorale.
- Të përdorë platformat, mjetet dhe pajisjet digjitale për matjen, regjistrimin dhe monitorimin e parametrave përkatës në fermat bujqësore dhe blegtorale;
- Të vlerësojë kushtet mjedisore për kultivimin e kulturave bujqësore dhe rritjen e kafshëve bujqësore;
- Të zbatojë teknologjitë e kultivimit të kulturave bujqësore;
- Të kryejë kontrollin digjital të parametrave klimatikë dhe tokësorë në prodhimin bimor.
- Të vlerësojë karakteristikat e tokave në përputhje me kërkesat e kulturave bujqësore.
- Të argumentojë mënyrat e ndërtimit dhe funksionimit të rrjetit kullues dhe ujitës në fermë.
- Të zbatojë skemat e qarkullimit bujqësor në fermë.
- Të zbatojë mënyrat dhe teknikat e kontrollit të cilësisë së materialit mbjellës bimor dhe teknikat e mbjelljes së farave dhe fidanëve.

- Të kryejë shërbimet agroteknike në kulturat bujqësore.
- Të realizojë vjeljen/korrijen/kositjen, magazinimin dhe ruajtjen e prodhimit të kulturave bujqësore.
- Të zbatojë metodat e kontrollit digjital të dëmtuesve në bujqësi.
- Të zbatojë teknologjinë e mbarështimit blegtoral në fermë.
- Të kujdeset për mirëqenien dhe shëndetin e kafshëve të fermës.
- Të kujdeset për kafshët gjatë riprodhimit të tyre.
- Të përpunojë produktet bujqësore e blegtorale të fermës.
- Të kryejë kompostimin e mbetjeve organike me orgjinë bimore dhe blegtorale në fermë.
- Të përdorë dhe mirëmbajë makineritë, mjetet dhe pajisjet në zbatimin e teknologjive të prodhimit bimor dhe blegtoral.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë menaxhimit të fermave bujqësore e blegtorale.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të teknologjive të prodhimit bimor dhe blegtoral.
- Të zbatojë rregullat e higjienës gjatë kryerjes së veprimtarive në fermat bujqësore dhe blegtorale.
- Të përdorë mjete e pajisje digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale.

III. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtijshëm në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë kualifikim profesional. Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës në fermat bujqësore në sektorin publik ose privat në: prodhimin bujqësor të bimëve të arave; mbrojtjen e bimëve; në pika të grumbullimit të prodhimeve bujqësore; në fermat që mbarështojnë: gjedh për prodhim qumështi dhe mishi, të imta (të leshta dhe të dhirta), derra, shpendë, në njësi apo veprimtari të tjera që aktiviteti i tyre lidhet me mbarështimin e kafshëve të fermës apo të vetëpunësohet në drejtimet e sipër përmendura në fermën e vogël familjare. Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, (teknik/menaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” në kualifikimin profesional “Bujqësi”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesëm dhe universitare.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK

Plani mësimor për kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/9

			(272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK)	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	7 (238)
1	L-17-157-22	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-14-712-24	Teknologjitë e prodhimit bimor	2
3	L-28-714-24	Teknologjitë e prodhimit blegtoral	2
4	L-08-715-24	Përpunimi i prodhimit bimor dhe blegtoral	1
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-14-454-24	Prodhimi i fidanëve të kulturave drufrutore	66
2	M-14-1842-24	Kultivimi i bimëve të arave	51
3	M-14-2109-24	Mirëmbajtja e rrjetit kullues dhe ujitës në fermë	60
4	M-14-2110-24	Vjelja dhe ruajtja e prodhimeve biologjike të fermës	60
5	M-08-2111-24	Përpunimi i prodhimeve bimore dhe blegtorale të fermës.	84
6	M-28-2112-24	Kujdesi për mirëqënien dhe shëndetin e kafshëve të fermës	51
7	M-28-2113-24	Kujdesi për kafshët dhe higjienën gjatë mbarështimit të tyre	36
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (102)
1	M-14-1956-24	Mbrojtja e integruar në bujqësi	51
2	M-14-947-24	Ujitja e bimëve të arave dhe perimeve	51
3	M-19-2114-24	Përpunimi dhe ruajtja e ushqimeve foragjere për blegtorinë	51
4	M-14-2115-24	Përdorimi i digjitalizimit për menaxhimin e fermës	51
5	M-14-1597-24	Trajtimi i kafshëve për prodhim qumështi e mishi	51
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1020/1054)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për profilet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).

- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësimdhënësit e lëndëve teorike profesionale dhe/ose moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritetit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “*të nxënit duke bërë*” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK. Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimi (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të kualifikimit profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohuri, shprehje, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e ndërtimit, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit III të KSHK.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli III i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Certifikatën profesionale dhe Suplementin përkatës, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga Ministria përgjegjëse e AFP-së, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale,
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit III të KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-22). Kl. 12 – 68 orë

- **Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror.
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve.
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse.
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhëshme.
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme.
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore.
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup.
- të analizojnë veçoritë e gatishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore.
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore.
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efikasitet burimet e ndryshme si mjedisin, burimet njerëzore, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme.

- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, inovacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes.
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale.
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre.
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve.
- të përshkruajnë marrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 68 orë**

Tema 1	Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes	3 orë
Tema 2	Aftësitë dhe sjellja sipërmarrëse	3 orë
Tema 3	Vetvlerësimi i potencialit personal	3 orë
Tema 4	Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive	4 orë
Tema 5	Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja	4 orë
Tema 6	Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve	3 orë
Tema 7	Etika e komunikimit dhe negocimit	4 orë
Tema 8	Puna individuale dhe puna në grup	4 orë
Tema 9	Gatishmëria, iniciativa dhe motivimi	3 orë
Tema 10	Përgjegjësia individuale dhe shoqërore	3 orë
Tema 11	Menaxhimi eficient i burimeve	3 orë
Tema 12	Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes	3 orë
Tema 13	Globalizimi, informacioni, inovacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale	5 orë
Tema 14	Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale	3 orë
Tema 15	Format e organizimit të sipërmarrjeve	5 orë
Tema 16	Konteksti i sipërmarrjeve, tregjet, klientela, konkurenca, kostot etj.	6 orë
Tema 17	Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve	5 orë
Tema 18	Marrëdhëniet e punës	4 orë

2. Lënda “Teknologjitë e prodhimit bimor ” (L- 14-712-24) Kl. 12 – 68 orë

• **Synimet e lëndës “Teknologjitë e prodhimit bimor”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknologjitë e prodhimit bimor”, kl.12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajë objektin dhe rëndësinë e teknologjive të prodhimit bimor.
- Të përshkruajë elementet përbërëse të agroekosistemit.
- Të përshkruajë kushtet mjedisore të nevojshme për prodhimin bimor.
- Të përshkruajë kushtet klimatike dhe ndikimin e tyre në kultivimin e kulturave bujqësore sipas llojit dhe zonave ekologjike.
- Të listojë platformat, mjetet dhe pajisjet digjitale për matjen dhe regjistrimin e

parametrave agroklimatikë.

- Të shpjegojë metodat që përdoren për vlerësimin e kushteve klimatike në prodhimin bimor.
- Të përshkruajnë ndikimin e ndryshimeve klimatike te kulturat bujqësore, si dhe masat mbrojtëse ndaj ndryshimeve klimatike.
- Të shpjegojë llojet e tokave dhe karakteristikat e tyre në përputhje me kërkesat e kulturave bujqësore.
- Të shpjegojë cilësive fiziko-kimike të tokës dhe ndikimin e tyre në prodhimin bimor.
- Të përshkruajnë hapat teknologjike të përgatitjes së tokës për mbjelljen e kulturave bujqësore.
- Të përshkruajnë rëndësinë e sistemimit të tokës dhe llojet e sistemimeve sipërfaqësore.
- Të shpjegojë skemat e ndërtimit dhe funksionimit të rrjetit kullues dhe ujitjes.
- Të shpjegojë skemat e qarkullimit bujqësor dhe rëndësinë e tyre në prodhimin bimor.
- Të shpjegojë parimet e përgjithshme, rolin dhe skemat e qarkullimit bujqësor sipas zonave ekologjike.
- Të shpjegojë bashkëshoqërimet bimore dhe rolin e tyre në ruajtjen e pjellorisë së tokës.
- Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e përdorimit të makinerive, mjeteve dhe pajisjeve në zbatimin e teknologjive të prodhimit bimor.
- Të argumentojë mënyrat e punimit bazë dhe plotësues të tokës sipas kulturave bujqësore.
- Të përshkruajnë elementët kryesore ushqyes të tokës (mikro dhe makroelementët) dhe rolin e tyre në jetën e bimës.
- Të shpjegojë llojet e plehrave, mënyrat dhe teknikat që përdoren në plehërimin bazë dhe plotësues të tokës.
- Të shpjegojnë llojet e plehrave organike dhe kompostot që përdoren në prodhimin bimor.
- Të argumentojë rëndësinë e përzgjedhjes dhe kontrollit të cilësisë së materialit mbjellës bimor.
- Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbjelljes së materialit mbjellës bimor.
- Të shpjegojë llojet e fidanishteve dhe teknologjitë e prodhimit të fidanëve.
- Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbjelljes së farave të bimëve të ndryshme në fushë dhe mjedise të mbrojtura.
- Të shpjegojë afatet, normat e farës, distancat e mbjelljes sipas llojit të kulturave bujqësore.
- Të përshkruajë teknologjitë e kultivimit të bimëve të arave.
- Të përshkruajë teknologjinë e kultivimit të të lashtave.
- Të përshkruajë teknologjinë e kultivimit të të vonave.
- Të përshkruajë teknologjinë e kultivimit të bishtajoreve për kokërr.
- Të përshkruajë teknologjinë e kultivimit të kulturave industriale.
- Të përshkruajë teknologjinë e kultivimit të bimëve aromatike dhe mjekësore.
- Të përshkruajë teknologjinë e kultivimit të duhanit.
- Të përshkruajë teknologjinë e kultivimit të patates.
- Të përshkruajë teknologjinë e kultivimit të perimeve në fushë të hapur dhe në mjedise të mbrojtura.
- Të përshkruajë teknologjinë e kultivimit të bimëve zbukuruese dhe luleve.

- Të përshkruajë teknologjinë e kultivimit të kulturave foragjere si bazë ushqimore për blegtorinë.
- Të përshkruajë teknologjinë e menaxhimit të bimësive të kullotave.
- Të përshkruajë teknologjitë e kultivimit të kulturave drufrutore.
- Të përshkruajë teknologjitë e prodhimit biologjik në prodhimin bimor.
- Të shpjegojë shërbimet agroteknike që bëhen në prodhimin bimor.
- Të shpjegojë mënyrat, teknikat e automatizuara dhe kontrollin digjital të ujitjes dhe të ushqyerit të bimëve.
- Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e krasitjeve të kulturave bujqësore.
- Të shpjegojë llojet e sëmundjeve dhe dëmtuesve të kulturave bujqësore.
- Të analizojnë metodat e vrojtimit, të prognozimit e të sinjalizimit të sëmundjeve dhe të dëmtuesve të kulturave bujqësore.
- Të shpjegojë llojet kryesore të produkteve të lejuara të mbrojtjes së bimëve në bujqësi.
- Të përshkruajnë metodat e ndryshme të kontrollit të sëmundjeve dhe dëmtuesve të kulturave bujqësore sipas zonave ekologjike.
- Të shpjegojë protokollat e trajtimeve të mbrojtjes së bimëve sipas kalendarëve vjetorë.
- Të përshkruajë metodat e kontrollit digjital të dëmtuesve në bujqësi.
- Të përshkruajë metodat e kontrollit biologjik të dëmtuesve në bujqësi dhe preparatet biologjike të lejuara.
- Të përshkruajë disa nga dëmtuesit e prodhimeve të ruajtura në magazina dhe masat e kontrollit të tyre.
- Të shpjegojë metodat dhe teknikat e përcaktimit të kohës së pjekjes për vjelje/korrje/kositje të kulturave bujqësore.
- Të listojë platformat digjitale që përdoren për monitorimin e kohës së vjeljes së prodhimeve bujqësore.
- Të shpjegojë metodat dhe teknikat e vjeljeve/korrjes/kositjes të prodhimeve bujqësore.
- Të shpjegojë mënyrat e grumbullimit dhe transportit të sigurt të prodhimeve bujqësore.
- Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e seleksionimit të prodhimit bujqësor.
- Të argumentojë përcaktimin e kushteve të magazinimit të prodhimeve bujqësore.
- Të listojë llojet dhe mënyrat e ambalazhimit të prodhimeve bujqësore dhe ambalazhet ekologjike.
- Të shpjegojë kushtet dhe masat mbrojtëse për ruajtjen e prodhimeve bujqësore.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknologjitë e prodhimit bimor ” kl.12 -68 orë**

Tema 1	Rëndësia e kushteve mjedisore të nevojshme për prodhimin bimor	5 orë
Tema 2	Platformat dhe pajisjet digjitale për matjen dhe regjistrimin e parametrave agroklimatikë	4 orë
Tema 3	Mirëmbajtja e rrjetit kullues dhe ujitjes në fermë	4 orë
Tema 4	Skemat e qarkullimit bujqësor dhe rëndësinë e tyre në prodhimin bimor	6 orë
Tema 5	Rëndësia, llojet e plehrave dhe plehërimi i tokës në prodhimin bimor	4 orë
Tema 6	Përzgjedhja dhe kontrolli i cilësisë së materialit mbjellës bimor	4 orë
Tema 7	Teknologjitë e prodhimit të fidanëve	4 orë
Tema 8	Teknologjitë e kultivimit të bimëve të arave	4 orë
Tema 9	Teknologjinë e kultivimit të perimeve	8 orë
Tema 10	Teknologjinë e kultivimit të kulturave foragjere	4 orë

Tema 11	Teknologjinë e kultivimit të kulturave drufrutore	3 orë
Tema 12	Shërbimet agroteknike dhe kontrolli digjital i dëmtuesve në bujqësi	6 orë
Tema 13	Teknologjitë e prodhimit biologjik në prodhimin bimor	4 orë
Tema 14	Vjelja/korrja/kositja e kulturave bujqësore dhe platformat digjitale për monitorimin e kohës së vjeljes	5 orë
Tema 15	Magazinimi dhe ruajtja e prodhimeve bujqësore, kontrolli digjital i kushteve të ruajtjes	3 orë

3. Lënda “Teknologjitë e prodhimit blegtoral” (L-28-714-19). Kl. 12 – 68 orë

• Synimet e lëndës “Teknologjitë e prodhimit blegtoral”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknologjitë e prodhimit blegtoral”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojë llojet e kafshëve dhe shpendëve që mbarështohen në fermë;
- Të shpjegojë treguesit normal jetësorë të kafshëve dhe shpendëve në fermë;
- Të shpjegojë kushtet e strehimit dhe mikroklimës në stallë sipas llojit të kafshëve, shpendëve dhe kategorive të tjera;
- Të shpjegojë llojet e ushqimeve, përdorimi i tyre sipas karakteristikat dhe kategorive të kafshëve dhe shpendëve;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të racioneve ushqimore sipas kategorive të kafshëve, shpendëve dhe destinacionit të prodhimit;
- Të shpjegojë teknologjitë e të ushqyerit të kafshëve dhe shpendëve në fermat blegtoriale sipas ciklit jetësor dhe destinacionit të prodhimit;
- Të shpjegojë mënyrat e parandalimit të kontaminimit të ushqimeve të kafshëve;
 - Të listojë pajisjet e automatizuara dhe të kontrollit digjital për ushqyerjen, matjen e parametrave shëndetësore, riprodhuese dhe mjeljen e kafshëve duke përshtetur përdorimet e tyre;
 - Të listojë pajisjet digjitale për monitorimin e parametrave mikroklimatikë në stallë dhe për të përcaktuar vendndodhjen e kafshëve në kullotë;
 - Të shpjegojë shenjat klinike të sjelljes jo normale të kafshëve dhe shpendëve;
 - Të shpjegojë rëndësinë e përshtatjes së të ushqyerit sipas llojit, kategorive të kafshëve, shpendëve dhe gjendjes fiziologjike;

- Të shpjegojë rëndësinë e higjienës të ujit, mjeteve dhe impianteve të tij, rëndësinë e zbatimit të standardeve të higjienës gjatë procesit të mjeljes;
- Të përshkruajë llojet e detergjenteve, dezinfektantëve dhe të pastruesve të lejuar dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë procedurat e pastrimit të impianteve mjelës, enëve apo pajisjeve të qumështit;
- Të shpjegojë teknologjitë e grumbullimit dhe ruajtjes së prodhimeve blegtorale;
- Të shpjegojë mënyrat e përpunimit të plehut dhe kompostimit të mbetjeve organike, mënyrat e riciklimit të mbetjeve shtazore dhe bimore;
- Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e përdorimit të makinerive, mjeteve dhe pajisjeve në zbatimin e teknologjive të prodhimit blegtoral;
- Të interpretojë aktet ligjore dhe nënligjore që veprojnë në fushën e mirëqenies së kafshëve dhe shpendëve;
- Të dallojë veçoritë e pjelljes në kafshë të ndryshme, si dhe të kujdeset dhe trajtojë kafshët gjatë dhe pas pjelljes;
- Të shpjegojë burimet e infeksionit të kafshët dhe shpendët;
- Të argumentojë masat për profilaksinë e përgjithshme;
- Të përshkruajë rëndësinë e masave veterinarë, për mbrojtjen e shëndetit publik;

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Teknologjitë e prodhimit blegtoral" kl. 12 - 68 orë**

Tema 1	Llojet e kafshëve dhe shpendëve që mbarështohen në fermë.	4 orë
Tema 2	Kushte e strehimit dhe mikroklima në stallë.	6 orë
Tema 3	Ushqimet, përdorimi, racionimi i tyre, sipas llojeve dhe kategorive të kafshëve dhe shpendëve.	6 orë
Tema 4	Teknologjitë e të ushqyerit të kafshëve dhe shpendëve të fermës sipas drjetimit ekonomik.	12 orë
Tema 5	Parandalimi i kontaminimit të ushqimeve.	2 orë
Tema 6	Platformat dhe pajisjet e automatizuara dhe të kontrollit digjital për proceset e punës dhe mjedisin e fermës.	8 orë
Tema 7	Sigurimi i higjienës në fermën blegtorale	7 orë
Tema 8	Teknologjitë e grumbullimit dhe ruajtjes së prodhimeve blegtorale	4 orë
Tema 9	Teknikat e përdorimit të makinerive, mjeteve dhe pajisjeve në prodhimin blegtoral	2 orë
Tema 10	Përpunimi i plehut, kompostimi i mbetjeve organike dhe mënyrat e riciklimit të mbetjeve në fermë.	4 orë
Tema 11	Mirëqenia e kafshëve dhe shpendëve në fermë.	2 orë
Tema 12	Treguesit normal jetësorë të kafshëve dhe shpendëve të fermës	2 orë
Tema 13	Kujdesi dhe trajtimi i kafshëve gjatë dhe pas pjelljes.	4 orë
Tema 14	Burimet e infeksionit të kafshët dhe shpendët dhe masat sanitorio-veterinare.	5 orë

4. Lënda “Përpunimi i prodhimit bimor dhe blegtoral” (L-08-715-24), Kl.12 – 34 orë

- Synimet e lëndës “Përpunimi i prodhimit bimor dhe blegtoral”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Përpunimi i prodhimit bimor dhe blegtoral”, kl.12, nxënësit duhet:

- Të theksojë rëndësinë ekonomike të përpunimit e ruajtjes së prodhimeve bujqësore e blegtorale.
- Të shpjegojë mënyrat, teknikat dhe mjetet e pastrimit të prodhimeve bimore dhe blegtorale.
- Të përshkruajë mënyrat dhe materialet për pastrimin dhe higjienizimin e prodhimeve bimore dhe blegtorale për përpunim.
- Të përshkruajë llojet e pajisjeve dhe mjeteve të punës për përpunime të thjeshta të prodhimeve bimore dhe blegtorale.
- Të shpjegojë mënyrat e parapërgatitjes së lëndëve të para bimore dhe blegtorale për përpunime të thjeshta.
- Të listojë llojet e prodhimeve bimore dhe blegtorale për përpunime të thjeshta.
- Të shpjegojë teknologjitë e përpunimit artizanal të drithërave.
- Të shpjegojë teknologjitë e përpunimit të frutave për komposto, lëngje, reçel, prevede etj.
- Të përshkruajë cilësitë, përbërjen kimike të frutave dhe rrushit që përdoren si lëndë e parë për përpunim.
- Të përshkruajë teknologjinë e përpunimit të perimeve për salcë, turshi etj.
- Të përshkruajë teknologjinë e përpunimit artizanal të ullirit për vaj dhe për konservim.
- Të listojë llojet e konservantëve që përdoren për përpunime të thjeshta të frutave, rrushit dhe perimeve.
- Të përshkruajë mënyrat e ambalazhimit e të ruajtjes së produkteve të përpunuara të frutave dhe rrushit.
- Të tregojë mënyrat e ambalazhimit e të ruajtjes së produkteve të përpunuara të perimeve.
- Të tregojë mënyrat e ambalazhimit e të ruajtjes së produkteve të përpunuara të ullirit.
- Të shpjegojë cilësitë, përbërjen kimike, mënyrat, teknikat dhe mjetet e përpunimit artizanal të qumështit.
- Të përshkruajë rëndësinë, mjetet dhe teknologjinë e përpunimit të qumështit për konsum të freskët, kos, djathë, gjizë etj.
- Të tregojë mënyrat e ambalazhimit e të ruajtjes të produkteve të përpunuara të qumështit.
- Të përshkruajë rëndësinë, cilësitë, përbërjen kimike dhe teknologjinë e përpunimit artizanal të mishit.
- Të përshkruajnë rëndësinë e kontrollit të kafshëve dhe të shpendëve para therjes së tyre.
- Të tregojë mjetet dhe pajisjet dhe mënyrat e therjes së kafshëve e shpendëve.
- Të tregojë mënyrat e ambalazhimit e të ruajtjes së produkteve të përpunuara të mishit.
- Të përshkruajë mënyrat e përpunimit të prodhimit foragjer si ushqim për blegtorinë.
- Të përshkruajë llojet e ambalazheve ekologjike dhe teknikat e ambalazhimit të produkteve bimore dhe blegtorale të përpunuara.
- Të shpjegojë kushtet teknike për ruajtjen e produkteve të përpunuara bimore dhe blegtorale.
- Të përshkruajë kushtet e higjienës dhe sigurisë gjatë përpunimit dhe ruajtjes së produkteve bimore dhe blegtorale.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Përpunimi i prodhimit bimor dhe blegtoral”, kl 12 - 34 orë**

•

Tema 1	Rëndësia e përpunimit dhe e ruajtjes të prodhimeve bimore dhe blegtorale.	2 orë
Tema 2	Përpunimi dhe ruajtja e drithrave	4 orë
Tema 3	Përpunimi dhe ruajtja e frutave	4 orë
Tema 4	Përpunimi dhe ruajtja e rrushit	5 orë
Tema 5	Përpunimi dhe ruajtja e perimeve	5 orë
Tema 6	Përpunimi dhe ruajtja e ullirit	4 orë
Tema 7	Përpunimi dhe ruajtja e qumështit	5 orë
Tema 8	Përpunimi dhe ruajtja e mishit	5 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Prodhimi i fidanëve të shartuar të kulturave drufrutore”

Kualifikimi : Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PRODHIMI I FIDANËVE TË SHARTUAR TË KULTURAVE DRUFRUTURE	M-14-454-24
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për zbatimin e teknikave për zgjedhjen e materialit shumëzues, përgatitjen e materialit shumëzues, shartimin, shërbimet agroteknike gjatë procesit të prodhimit të fidanave drufrutore si dhe llogaritjen e shpenzimeve në prodhimin e fidanave të shartuar të kulturave drufrutore.	
Kohëzgjatja e modulit	66 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin profesional “Bujqësi”, Niveli II në KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi/ja siguron copat për nënshartesa. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë: – të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës. – të përcaktojë nënshartesat për secilën kulturë drufrutore. – të bëjë vlerësimin e copave që do të përdoren për nënshartesa. – të pastrojë copat nga papastërtitë sipas kriterëve teknike. – të bëjë prerjen e copave sipas standarteve teknike. – të ruajë copat në rërë të pastër dhe të lagur. – të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme gjendjen e copave. – të përcaktojë fuqinë mbirëse të copave. – të pastrojë dhe mirëmbajë veglat dhe vendin e punës duke respektuar rregullat. – të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë sigurimit të copave për nënshartesa. – të zbatojë me rigorizitet rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë sigurimit të copave për nënshartesa. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli	

RN 2 Nxënësi/ja prodhon filizë për nënshartesa

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- të kontrollojë dhe përgatisë veglat, pajisjet dhe materialet e punës.
- të përzgjedhë veglat, mjetet dhe materialet e tjera për prodhimin e fidanëve për nënshartesa.
- të përzgjedhë vendin për ngritjen e farishtes sipas kriterëve teknike.
- të përzgjedhë tokën për mbjelljen e copave për nënshartesa sipas kriterëve teknike.
- të transportojë veglat, mjetet dhe materialet e tjera në vendin e përzgjedhur.
- të llogarisë distancat e mbjelljes në favor të mekanizimit.
- të piketojë rreshtat duke respektuar distancat e mbjelljes.
- të llogarisë sasinë e copave së nevojshme për mbjellje.
- të mbjellë në thellësinë e duhur copat për nënshartesa.
- të kryejë përkujdesjet pas mbirjes së nënshartesave sipas kriterëve teknike.
- të kryejë rrallimin e fidanëve duke respektuar distancat e duhura.
- të kryejë zëvendësimin e filizave ku është e nevojshme.
- të kryejë shërbimet teknike sipas nevojave të filizave.
- të kontrollojë hapjen e lëvores nga druri.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë prodhimit të filizave për nënshartesa.
- të zbatojë me rigorizitet rregullat e sigurimin teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë mbjelljes së copave për prodhimin e filizave për nënshartesa.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Nxënësi/ja kryen shartim me kalem.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- të përzgjedhë materialet, veglat e pajisjet përkatëse për shartim me kalem me çarje të plotë në kulturat drufrutore.
- të transportojë veglat, pajisjet e materialet në pemëtore.
- të përgatisë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për shartim.
- të përcaktojë llojin e kulturës që do të shartohen me kalem sipas kriterëve të përcaktuara.
- të përcaktojë llojin e kulturës ku do të merrën copat për mbishartesë sipas kriterëve të përcaktuara.

- të realizojë prerjen e copave të nënshartesës sipas hapave të punës.
- të realizojë prerjen e copave të mbishartesës sipas hapave të punës.
- të shtratifikojë në rërë të pastër dhe të ruajë copat në kushte optimale.
- të zbatojë teknikën e prerjeve për përgatitjen e nënshartesës.
- të zbatojë teknikën e prerjeve për përgatitjen e kalemave si mbishartesë.
- të realizojë vendosjen dhe puthitjen e mbishartesës me nënshartesën sipas procedurës.
- të kryejë lidhjen e vendit të shartimit sipas mënyrës së duhur.
- të kryejë izolimin e vendit të shartimit me material ngjitës.
- të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme zënien e shartimit.
- të pastrojë dhe sistemojë vendin punës.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë kryerjes së shartimit me kalem.
- të zbatojë me rigorizitet rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë shartimit me kalema në kulturat drufrutore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Nxënësi/ja kryen shartim me syth

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- të përzgjedhë materialet, veglat, paisjet përkatëse për shartim me syth.
- të transportojë veglat, pajisjet, materialet në vendin e punës dhe t'i përgatisë ato për punë.
- të përcaktojë pemët që do të shartohen.
- të presë në formë "t"-je me gjatësi 3 cm me 2 cm nënshartesën.
- të përgatisë mbishartesë me një sythë pak lëvore dhe ind drunor.
- të vendosë me kujdes, sythin te nënshartesa.
- të puthisë, siç duhet, nënshartesa me mbishartesës.
- të lidhë me kujdes, pjesëtarët e shartimit.
- të izolojë vendin e shartimit me material ngjitës sipas procedurës.
- të pastrojnë dhe sistemojë vendin e punës.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët,

- klientët dhe kolegët gjatë kryerjes së shartimit me syth.
- të zbatojë me rigorizitet rregullat sigurimit teknik dhe ruajtjen e mjedisit gjatë shartimit me sythë në kulturat drufrutore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 5 Nxënësi/ja kryen shërbime në shartesore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- të përzgjedhë materialet, veglat, pajisjet përkatëse për kryerjen e shërbimeve.
- të transportojë veglat, pajisjet, materialet në vendin e punës dhe t'i përgatisë ato për punë.
- të kryejë pastrimin e nëshartesës nga thithakët.
- të kryejë pastrimin e mbishartesës nga lastaret e tepërt.
- të kryejë punimin e tokës në shartesore.
- të kryejë plehërimin e shartesorës.
- të kryejë ujitjet e fidanëve frutorë.
- të kryejë krasitjet e fidanëve të shartuar.
- të kryejë trajtimet e mbrojtjes së bimëve e fidanëve të shartuar.
- të pastrojnë dhe sistemojnë vendin e punës.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë kryerjes së shërbimeve në shartesore.
- të zbatojë me rigorizitet rregullat sigurimit teknik dhe ruajtjen e mjedisit gjatë shërbimit të fidanë të shartuar në kulturat drufrutore

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Nxënësi/ja kryen klasifikimin, etiketimin dhe ruajtjen e fidanëve të shartuar.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- të përzgjedhë materialet, veglat, pajisjet përkatëse për klasifikimin, etiketimin dhe ruajtjen e fidanëve të shartuar.
- të transportojë veglat, pajisjet, materialet në vendin e punës dhe t'i përgatisë ato për punë.
- të kryejë shkuljen e fidanëve sipas standardit.
- të kryejë klasifikimin e fidanëve sipas standardit.
- të kryejë vendosjen e etiketave sipas kategorive.
- të transportojë dhe të ruajnë fidanë sipas standardit.
- të pastrojnë dhe sistemojnë vendin e punës.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët,

klitentët dhe kolegët gjatë kryerjes së klasifikimit, etiketimit dhe ruajtjes së fidanëve të shartuar.

- të zbatojë me rigorizitet rregullat sigurimit teknik dhe ruajtjen e mjedisit gjatë prodhimit të fidanëve të shartuar në kulturat drufrutor

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 7 Nxënësi/ja kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e fidanëve të kulturave drufrutore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë fletë kërkesën për bazë materiale.
- të përgatisë preventivin e shpenzimeve që duhen gjatë prodhimit të fidanëve të kulturave drufrutore.
- të njehsojë kostot e prodhimit të fidanëve të kulturave drufrutore, sipas manualit përkatës.
- të njehsojë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet shoqërore etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogarisë detyrimet fiskale të klasifikimit, etiketimit dhe ruajtjes së fidanëve të shartuar, sipas formularëve përkatës.
- të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për klasifikimin, etiketimin dhe ruajtjen e fidanëve të shartuar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjediset e shkollës ose në fidanishte të kulturave drufrutore.
 - Mësimdhënësi i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të sigurimit të copave për nënshartesa, prodhimin të filizave për nënshartesa, shartimin e filizave me syth dhe me kalem, kryerjen e shërbimeve në shartesore, klasifikimin, etiketimin dhe ruajtjen e fidanëve të shartuar, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me prodhimin e fidanëve të drufrutorëve.
 - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për sigurimin e copave për nënshartesa, prodhimin e filizave për nënshartesa, shartimin e filizave me kalem dhe me syth, kryerjen e shërbimeve në shartesore, klasifikimin, etiketimin dhe ruajtjen e fidanëve të shartuar, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me prodhimin e fidanëve të drufrutorëve.
 - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta për prodhimin e copave për nënshartesa, prodhimin e filizave për nënshartesa, shartimin e filizave me kalem dhe syth, si dhe kryerjen e shërbimeve në shartesore.
-

-
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve për prodhimin e fidanëve të shartuar të drufrutorëve.
 - Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit gjatë prodhimit të fidanëve të shartuar të kulturave drufrutore.
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të prodhimit të copave për nënshartesa, prodhimit të filizave për nënshartesa, shartimin e filizave me kalem dhe me syth, kryerjes së shërbimeve në shartesore, si dhe të përdorimit të mjeteve të punës për prodhimin e fidanëve të shartuar të kulturave drufrutore.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha, kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
-

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- Thika shartimi
 - Gërshërë
 - Rrafje
 - Material ngjitës shartimi
 - Fara bimësh të egra
 - Piketa, etiketa
 - Plehra kimike
 - Pesticide
 - Rërë
 - Pajisje kancelarie
 - Makina llogaritëse dore
 - Manualet e preventivimit për zbërthimin e kostos
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e prodhimit të fidanëve frutorë (kodi i punës, legjislacioni fiskal)
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

2. Moduli “Kultivimi i bimëve të arave”

Kualifikimi : Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	KULTIVIMI I BIMËVE TË ARAVE	M-14-1842-24
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për kultivimin e bimëve të arave, elementët kryesorë të teknologjisë së kultivimit të bimëve të arave si dhe për llogaritjet e thjeshta ekonomike lidhur me kultivimin e tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin profesional “Bujqësi”, Niveli II në KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN1	Nxënësi/ja vlerëson cilësitë e tokës për kultivimin e bimëve të arave. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë: – të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës. – të përcaktojë vetitë fizike dhe kimike të tokës. – të identifikojë humusin dhe mikroorganizmat në tokë. – të analizojë faktorët që ndikojnë në cilësinë e tokës bujqësore. – të vlerësojë faktorët ekologjik të tokës. – të marrë mostrat e tokës për analiza pedologjike dhe agrokimike të saj. – të interpretojë rezultatin e analizave të tokës për vlerësimin e cilësive të tokës bujqësore. – të argumentojë rolin e makro dhe mikroelementeve gjatë kultivimit të bimëve të arave. – të shpjegojë rëndësinë e plehrave organike për zhvillimin e bimëve të arave. – të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë vlerësimit të cilësive të tokës për kultivimin e bimëve të arave. – të zbatojë me rigorizitet rregullat sigurimit teknik dhe ruajtjen e mjedisit gjatë vlerësimit të cilësive të tokës për kultivimin e bimëve të arave. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli

RN 2 Nxënësi/ja vlerëson faktorët ekologjikë të kultivimit të bimëve të arave.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- të kontrollojë dhe përgatisë veglat, pajisjet dhe materialet e duhura për punë.
- të vlerësoj kushtet optimale për mbjelljen e bimëve të arave.
- të përshkruajë rolin e faktorëve ekologjik gjatë kultivimit të bimëve të arave.
- të përzgjedhë bimët e arave sipas kushteve ekologjike të zonës së kultivimit.
- të përshkruajë kushtet mjedisore të ekosistemit lokal për kultivimin e bimëve të arave.
- të përshkruajë parametrat agroklmatikë dhe orientimin gjeografik në zonën e kultivimit të bimëve të arave.
- të listojë platformat, mjetet dhe pajisjet digjitale për matjen dhe regjistrimin e parametrave agroklmatikë në kultivimin e bimëve të arave.
- të përzgjedhë veglat, mjetet dhe materialet e tjera për kultivimin e bimëve të arave.
- të përzgjedhë vendin për kultivimin e bimëve të arave.
- të transportojë veglat, mjetet dhe materialet e tjera në vendin e përzgjedhur.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë vlerësimit të faktorëve ekologjikë kultivimit të bimëve të arave.
- të zbatojë me rigorizitet rregullat sigurimit teknik dhe ruajtjen e mjedisit gjatë vlerësimit të faktorëve ekologjikë të kultivimit të bimëve të arave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN3 Nxënësi/ja përgatit tokën për mbjelljen e bimëve të arave.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- të sigurojë veglat dhe materialet e nevojshme për kryerjen e shëbimeve për mbjelljen e bimëve të arave.
- të caktojë vendin për përgatitjen e tokës për mbjellje, sipas parabimës dhe përbërjes mekanike të tokës.
- të shpërndajë plehrat organike e minerale sipas nevojës të llojit të bimëve të arave.
- të kryejë punimin e tokës sipas karakteristikave të tokës dhe llojit të kultivarit.
- të zbatojë metodat agroteknike të përgatitjes së shtratit të tokës sipas sipas kërkesave të kulturave të bimëve të arave.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët,

dhe kolegët gjatë përgatitjes së tokës për mbjelljen e bimëve arave.

- të zbatojë me rigorizitet rregullat sigurimit teknik dhe ruajtjen e mjedisit gjatë përgatitjes së tokës për mbjelljen e bimëve të arave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi/ja kryen mbjelljen e bimëve të arave.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- të zgjedhë kohën më të përshtatshme për mbjellje.
- të përzgjedhë kultivarët e përshtatshëm për kushtet konkrete agroekologjike të fermës, sipas katalogut.
- të përzgjedhë kultivarët sipas kërkesës së tregut.
- të llogarisë normën e farës për mbjellje duke u bazuar në llojin e farës dhe afatit optimal të mbjelljes.
- të caktojë distancën dhe sasinë e farës për mbjellje sipas standardeve teknike.
- të caktojë afatin optimal për mbjellje.
- të bëjë dezinfektimin e farave me produktet e mbrojtjes së bimëve sipas kriterëve teknike.
- të mbushë makinën mbjellëse më farën e përzgjedhur.
- të bëjë mbjelljen e farave, me makina mbjellëse.
- të mbjellë në thellësinë e duhur farat, sipas kriterëve teknike.
- të kryejë ngjeshjen e lehtë të tokës pas mbjelljes.
- të kontrollojë mbirjen e farave.
- të kryejë përkujdesjet pas mbirjes së farave sipas nevojës.
- të kryejë rrallimin e bimëve duke respektuar distancat e duhura.
- të kryejë zevëndësimin e bimëve ku është e nevojshme.
- të kujdeset dhe mirëmbajë mjetet e punës pas përfundimit të punës.
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës pas kryerjes së mbjelljes.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë mbjelljes të bimëve të arave.
- të zbatojë me rigorizitet rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë mbjelljes të bimëve të arave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 5 Nxënësi/ja kryen shërbimet agroteknike gjatë kultivimit të bimëve të arave dhe vjeljen/korrjen/kositjen e tyre.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.

- të sigurojë veglat dhe materialet e nevojshme për kryerjen e shërbimeve për mbjelljen e bimëve të arave.
- të respektojë kohën më të përshtatshëm për kryerjen e shërbimeve agroteknike.
- të kryejë punime plotësuese gjatë kultivimit të bimëve.
- të kryejë plehërimet plotësuese me plehra kimike në varësi të fazave të zhvillimit dhe vatrave me bimësi më të dobët, sipas kritereve teknike.
- të kryejë kullimin nëse është e nevojshme në varësi të karakteristikave të tokës dhe kushteve agrometeorologjike.
- të kryejë ujitje nëse është e nevojshme në varësi të kushteve të motit.
- të kryjë trajtimet e mbrojtjes së bimëve sipas llojit të kulturës dhe teknologjisë së kultivimit.
- të zbatojë masa agroteknike kundër rrëzimit të bimëve.
- të kryejë korrijen/kositjen e bimëve të arave.
- të sigurojë veglat dhe materialet e nevojshme për kryerjen e shërbimeve për mbjelljen e bimëve të arave.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë kryerjes së shërbimeve agroteknike të kultivimit të bimëve të arave dhe vjeljen/korrijen/kositjen e tyre.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë gjatë kryerjes së shërbimeve agroteknike të kultivimit të bimëve të arave dhe vjeljen/korrijen/ko tyre.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 6 Nxënësi/ja kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për kultivimin e bimëve të arave.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të përgatisë fletë kërkesën për bazë materiale.
- të përgatisë preventivin e shpenzimeve që duhen gjatë procesit të prodhimit të bimëve të arave.
- të njehsojnë kostot e prodhimit të bimëve të arave, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin detyrimet fiskale të prodhimit të bimëve të arave, sipas formularëve përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për prodhimin e bimëve të arave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

**Udhëzime për
zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjediset e shkollës ose në ferma që kultivojnë bimë arash.
- Mësimdhënësi i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të sigurimit të farave të bimëve të arave, bazës mekanike të nevojëshme, inputeve bujqësore sipas kohës së përdorimit të tyre, kryerjen e shërbimeve agroteknike gjatë procesit të kultivimit të bimëve të arave, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me prodhimin e tyre.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për sigurimin e farës, mbjelljen, kryerjen e shërbimeve gjatë periudhës së vegjetacionit si dhe vjeljes së prodhimeve të tyre.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta për mbjelljen e farave sidhe kryerjen e shërbimeve agroteknike në vartësi të fazave të zhvillimit të tyre.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve për kultivimin e bimëve të arave.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit gjatë gjithë periudhës së kultivimit të bimëve të arave.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të mbjelljes së farave, shërbimeve në fazat kritike të zhvillimit të bimëve, kryerjes së shërbimeve në fushë, si dhe të përdorimit të mjeteve të punës për korrjen e bimëve të arave.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- Fara të bimëve të arave, makina mbjellëse, traktor
 - Makina korrëse-shirëse
 - Magazinë për prodhimet bujqësore
 - Lëmi i përpunimit të prodhimeve të bimëve të arave
 - Piketa, etiketa
 - Plehra kimike
 - Pesticide
 - Sisteme ujitëse
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualët e preventivimit për zërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e prodhimit bimor (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

3. Moduli “Mirëmbajtja e rrjetit kullues dhe ujitës në fermë”

Kualifikimi : Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	MIRËMBAJTJA E RRJETIT KULLUES DHE UJITËS NË FERMË	M-14-2109-24
Qëllimi i modulit	Ky modul i aftëson nxënësit për të mirëmbajtur rrjetin kullues dhe ujitës, garantimin e funksionimit cilësor të tyre si dhe sistemimin e dherave që dalin gjatë mirëmbajtjes së tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin profesional “Bujqësi”, Niveli II në KSHK.	

Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi/ja kryen procese pune për mirëmbajtjen e kanaleve të treta kulluese (K₃K). Kriteret e vlerësimit: Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë: – të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës. – të vlerësojë gjendjen teknike të kanaleve kulluese në fermën bujqësore. – të sigurojë materialet e nevojshme për kryerjen e shërbimeve për mirëmbajtjen e kanaleve kulluese. – të përzgjedhë veglat e duhura të punës (bel, lopatë, kazëm, zhalon, metër, kompas, spango etj.). – të përzgjedhë mjetet e përshtatshme të punës për pastrimin e kanaleve kulluese në funksion të procesit të punës. – të kryjë mirëmbajtjen e kanaleve kulluese në kohën e duhur. – të transportojë bazën materiale të punës për pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese sipas kërkesave teknike. – të garantojë pjerrësinë dhe thellësinë e kanalit kulluese sipas relievit dhe strukturës së tokës bujqësore. – të largojë dheun në vendin e duhur gjatë mirëmbajtjes së kanaleve kulluese. – të sistemojë dheun e nxjerrë nga kanali kullues e ta ngjeshë atë sipas kriterëve teknike. – të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë kryerjes së kryerjes së proceseve të punës për mirëmbajtjen e kanaleve kulluese. – të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të
--	-------------	--

mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së kryerjes së proceseve të punës për mirëmbajtjen e kanaleve kulluese.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 2 Nxënësi/ja kryen procese pune për hapjen dhe mirëmbajtjen e vijave kulluese.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- të vlerësojë vendin ku do të hapen vijat kulluese sipas tipit të tokës, llojit të kulturës dhe faktorëve agrometeorologjikë.
- të sigurojë materialet e nevojshme për hapjen e vijave ulluese në parcelë.
- të sigurojë materialet e nevojshme për mirëmbajtjen e vijave kulluese gjatë ciklit bimor.
- të përcaktojë mënyrën optimale, skemën e hapjes së vijave kulluese dhe regjimin përkatës të punës.
- të realizojë procesin e hapjes së vijave kulluese, sipas mënyrës, skemës dhe regjimit përkatës të punës.
- të kontrollojë gjendjen teknike të vijave kulluese gjatë gjithë vegetacionit.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë kryerjes së kryerjes së proceseve të punës për hapjen dhe mirëmbajtjen e vijave kulluese.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë hapjes e mirëmbajtjes së vijave kulluese.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Nxënësi/ja kryen procese pune për mirëmbajtjen e kanaleve të treta ujitëse (K₃U).

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- të vlerësojë gjendjen teknike të kanaleve ujitëse në fermën bujqësore.
- të sigurojë materialet e nevojshme për kryerjen shërbimeve për mirëmbajtjen e kanaleve ujitëse.
- të përzgjedhë veglat e duhura të punës (bel, lopatë, kazëm, zhalon, metër, kompas, spango etj.).
- të përzgjedhë mjetet e përshtatshme të punës për pastrimin e kanaleve ujitëse në funksion të procesit të punës.
- të kryjë mirëmbajtjen e kanaleve ujitëse në kohën e duhur.
- të transportojnë bazën materiale të punës për pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve ujitëse sipas kërkesave teknike.
- të garantojë pjerrësinë dhe thellësinë e kanalit ujitës sipas relievit dhe strukturës së tokës bujqësore.

- të largojë dheun në vendin e duhur gjatë pastrimit të kanaleve ujitëse.
- të sistemojë dheun e nxjerrë nga kanali ujitës e ta ngjeshë atë sipas kriterëve teknike.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët, gjatë kryerjes së proceseve të punës për mirëmbajtjen e kanaleve ujitëse.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë gjatë kryerjes së proceseve të punës për mirëmbajtjen e kanaleve ujitëse.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Nxënësi/ja kryen procese pune për hapjen dhe mirëmbajtjen e vijave ujitëse.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- të vlerësojë vendin ku do të hapen vijat ujitëse sipas tipit të tokës, llojit të kulturës dhe faktorëve agrometeorologjikë.
- të sigurojë materialet e nevojshme për hapjen e vijave ujitëse në parcelë.
- të sigurojë materialet e nevojshme për mirëmbajtjen e vijave ujitëse gjatë ciklit bimor.
- të përcaktojë mënyrën optimale, skemën e hapjes së vijave ujitëse dhe regjimin përkatës të punës.
- të realizojë procesin e hapjes së vijave ujitëse, sipas mënyrës, skemës dhe regjimit përkatës të punës.
- të kontrollojë gjendjen teknike të vijave ujitëse gjatë gjithë vegjetacionit.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientë kolegët gjatë kryerjes së kryerjes së proceseve të punës për hapjen dhe mirëmbajtjen e vijave ujitëse.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë hapjes e mirëmbajtjes së vijave ujitëse.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 5 Nxënësi/ja kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për mirëmbajtjen e rrjetit kullues dhe ujitës në fermë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të përgatisë fletë kërkesën për bazë materiale.
- të njehsojnë kostot e mirëmbajtjes së kanaleve kulluese dhe ujitëse në fermë, sipas manualit përkatës.
- të njehsojë preventivin e materialeve sipas manualit përkatës.
- të njehsojë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet

- shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
 - të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për mirëmbajtjen e rrjetit kullues dhe ujitës në fermë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul mund të trajtohet në fermën e shkollës ose në ferma të tjera pranë shkollës sipas mundësive që ofron zona.
- Gjatë trajtimit të modulit mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë demostrime konkrete të kryerjes së proceseve të punës gjatë mirëmbajtjes së rrjetit kullues dhe ujitës të tokës në fermë si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me këto procese pune.
- Nxënësit duhet të praktikohen sa më shumë të jetë mundur në përgatitjen për punë, si dhe proceset e pastrimit të rrjetit kullues e ujitës në fermë dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me këto procese pune.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve për kryerjen e proceseve të punës për mirëmbajtjen e rrjetit kullues e ujitës në fermë.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së proceseve të punës për mirëmbajtjen e rrjetit kullues dhe ujitës të tokës.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përgatitjes për punë, proceseve të punës gjatë mirëmbajtjes së rrjetit kullues e ujitës të tokës si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me këto procese pune.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen terreni, veglat dhe pajisjet e punës të mëposhtme:

- Skica të gatshme për rrjetin e kanaleve kulluese
 - Bel, lopatë, kazëm, zhalon, metër-shirit, spango etj.
 - Parcelë toke.
 - Vegla dhe pajisje për sistemimin e tokës bujqësore.
 - Pankarta, skica, udhëzues, katalogë, rregullore, etj.
 - Pajisje kancelarie, makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

4 .Moduli “Vjelja dhe ruajtja e prodhimeve biologjike të fermës“

Kualifikimi: Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	VJELJA DHE RUAJTJA E PRODHIMEVE BIOLOGJIKE TË FERMËS	M-14-2110-24
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të vjelë, grumbulluar dhe ruajtur prodhimet e marra nga kultivimet dhe mbarështimet me metodat e bujqësisë biologjike, si dhe për të zbatuar teknologjinë e ruajtjes së tyre sipas standardeve të caktuara.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi/ja përcakton shkallën e pjekjes për vjelje/ korrje/ kositje të prodhimit në bujqësinë biologjike. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë: – të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës. – të vëzhgojë ndryshimet fizike të prodhimeve bujqësore biologjike para vjeljes. – të vlerësojë ndryshimet kimike të prodhimeve bujqësore biologjike para vjeljes. – të vlerësojë ndryshimet fiziologjike të prodhimeve bujqësore biologjike para vjeljes. – të përcaktojë prognozën dhe kriteret e përcaktimit të shkallës së pjekjes për vjelje. – të vlerësojë maturimin e prodhimeve biologjike, sipas shkallës së pjekjes për vjelje. – të dallojë shkallën e maturimit të pjekjes së drithërave, bimëve industriale, vajore e foragjere biologjike. – të dallojë shkallën e maturimit të produkteve biologjike perimore. – të dallojë shkallën e maturimit të produkteve biologjike drufrutore dhe të rrushit; – të dallojë shkallën e maturimit të produkteve biologjike të agrumeve dhe ullirit. – të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë përcaktimit të shkallës së pjekjes për vjelje/korrje/kositje të prodhimit të kultivuar me metodat e bujqësisë biologjike.

-
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përcaktimit të shkallës së pjekjes për vjelje/korrje/kositje të prodhimit të kultivuar me metodat e bujqësisë biologjike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 2 Nxënësi/ja kryen vjeljen/korrjen/kositjen e kulturave bujqësore të kultivuar me metodat e bujqësisë biologjike.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet për vjeljen e kulturave bujqësore.
- të përzgjedhë llojin e kulturës bujqësore për vjelje/korrje/kositje (mollë, grurë, jonxhë etj.).
- të përcaktojë mënyrën e vjeljes sipas llojit të kulturës së përzgjedhur.
- të kryejë vjeljen e kulturave bujqësore biologjike me krahë ose në mënyrë mekanike.
- të vendosë me kujdes prodhimin e vjelë/korrur/kositur në ambalazhe të përshtatshme sipas llojit të produktit.
- të transportojë, me krah apo mjete mekanike, prodhimin e vjelë në magazinë.
- të seleksionojë prodhimin dhe standardizojë atë sipas drejtimit të prodhimit.
- të ambalazhojë prodhimin sipas destinacionit.
- të ruajë prodhimin në magazinë sipas kërkesave të përcaktuara të ruajtjes për çdo kulturë bujqësore.
- të pastrojë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet, mjetet dhe materialet pas vjeljes së kulturave bujqësore.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë kryerjes së vjeljes/korrjes/kositjes së kulturave bujqësore të kultivuar me metodat e bujqësisë biologjike.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së vjeljes/korrjes/kositjes së kulturave bujqësore të kultivuar me metodat e bujqësisë biologjike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Nxënësi/ja bën trajtimet para dhe pas vjeljes së prodhimit biologjik .

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- të listojë materialet, mjetet dhe teknikat e përdorura gjatë

- trajtimeve para dhe pas vjeljes të prodhimeve biologjike.
- të mbikqyrë trajtimet para dhe pas vjeljes të prodhimit biologjik.
- të mbikqyrë procesin e ftohjes të prodhimit biologjik pas vjeljes;
- të mbikqyrë proceset e pastrimit, seleksionimit të prodhimit biologjik, pas vjeljes;
- të mbikqyrë procesin e ruajtjes së prodhimit biologjik pas vjeljes;
- të kontrollojë procesin e transportit të prodhimeve biologjike, pas vjeljes;
- të mbikqyrë marketingun e prodhimeve biologjike deri te përdorimi nga konsumatori.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë trajtimeve para dhe pas vjeljes të prodhimeve biologjike.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë trajtimeve para dhe pas vjeljes të prodhimeve biologjike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Nxënësi/ja ruan prodhimet biologjike.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- të kontrollojë paraftohjen e prodhimeve biologjike.
- të kontrollojë ruajtjen e ftohtë të prodhimeve biologjike bimore.
- të kontrollojë ruajtjen e prodhimeve biologjike blegtorale.
- të kontrollojë kushtet optimale (temperaturën e magazinimit, lagështinë etj.) për ruajtjen e prodhimeve biologjike.
- të kontrollojë kushtet optimale për sigurimin e cilësisë së prodhimeve biologjike.
- të përzgjedhë metodat dhe teknologjitë e ndryshme të ruajtjes së produkteve bujqësore biologjike.
- të dallojë llojet e dhomave frigoriferike, magazinave dhe pajisjeve të ruajtjes së prodhimit bimor dhe blegtoral biologjik.
- të kontrollojë mjediset frigoriferike me atmosferë të kontrolluar (AK) për ruajtjen prodhimeve biologjike.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë ruajtjes së prodhimeve biologjike.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ruajtjes së prodhimeve biologjike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 5 Nxënësi/ja përdor teknologjitë e pasvjeljes sipas llojit të prodhimit biologjik.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- të dallojë anomalitë fiziologjike pas vjeljes së prodhimit bujqësor biologjik.
- të dallojë dëmtimet nga patogjenët pas vjeljes së prodhimit biologjik.
- të zbatojë kushtet higjieno-sanitare si faktorë të rëndësishëm për të reduktuar humbjet në sasi e cilësi të prodhimit bujqësor biologjik.
- të përzgjedhë teknologjitë e pasvjeljes sipas llojit të prodhimit bujqësor biologjik.
- të përzgjedhë teknologjitë e reja të pas vjeljes së prodhimit biologjike dhe sfidat e së ardhmes.
- të zbatojë teknologjitë e ambalazhimit dhe paketimit të prodhimit bimor biologjik.
- të zbatojë teknologjitë e ambalazhimit dhe paketimit të prodhimit blegtoral biologjik.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë zbatimit të teknologjive të pasvjeljes sipas llojit të produktit bujqësor biologjik.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të teknologjive të pasvjeljes sipas llojit të prodhimit bujqësor biologjik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN6 Nxënësi/ja zbaton standardet e proceseve të pas vjeljes së prodhimeve biologjike bimore e blegtoriale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- të respektojë standardet për transportin e prodhimit bujqësor biologjik sipas llojit.
- të respektojë standardet për seleksionimin e prodhimit bujqësor biologjik sipas llojit.
- të respektojë standardet për ambalazhimin e prodhimit bujqësor organik sipas llojit.
- të respektojë standardet e paketimit të prodhimit bujqësor biologjik.
- të respektojë standardet e etiketimit të prodhimit bujqësor biologjik.
- të përdorë teknologjitë e seleksionimit të prodhimit bujqësor biologjik.
- të përdorë teknologjitë e ambalazhimit të prodhimit

bujqësor biologjik.

- të përdorë teknologjitë e paketimit të prodhimit bujqësor biologjik.
- të përdorë teknologjitë e etiketimit të prodhimit bujqësor biologjik.
- të respektojë rregullat e etiketimit të prodhimit bimor dhe blegtoral.
- të vlerësojë llojet e ambalazhit për prodhimeve bujqësore biologjike dhe të përdorë ambalazhe ekologjike.
- të zbatojë teknologjitë e vendosjes së prodhimit biologjik për ruajtje.
- të dallojë llojet e konservantëve të lejuar që përdoren për produktet bujqësore biologjike dhe përdorimet e tyre.
- të përzgjedhë mënyrat dhe teknikat e manipulimit të prodhimit bujqësor biologjik për ruajtje dhe trajtim të mëtejshëm.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë zbatimit të standardeve të proceseve të punës të pasvëljes së prodhimeve biologjike bimore e blegtorale.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të standardeve të proceseve të punës të pasvëljes së prodhimeve biologjike bimore e blegtorale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 7 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për vjeljen dhe ruajtjen e prodhimeve biologjike bujqësore e blegtorale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të përgatisë fletë kërkesën për bazë materiale.
- të njehsojë kostot e vjeljes dhe ruajtjes të prodhimeve bujqësore e blegtorale, sipas manualit përkatës.
- të njehsojë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për vjeljen dhe ruajtjen e prodhimeve biologjike bujqësore e blegtorale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e bazës prodhuese të shkollës (mjedise magazinimi), në ekonomi bujqësore ku

	kultivohen bimët dhe mbarështrihen kafshët sipas metodave të bujqësisë biologjike. – Mësuesi/Instruktori duhet të përdorë sa më shumë që të jetë e mundur demonstrimet konkrete për vjeljen dhe ruajtjen e prodhimeve biologjike bujqësore e blegtorale sipas normave teknike të bujqësisë biologjike. – Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për kryerjen e një sërë operacionesh pune për vjeljen dhe ruajtjen e prodhimeve biologjike bujqësore e blegtorale sipas normave teknike të bujqësisë biologjike, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas të pavarur. – Nxënësit, nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës dhe rëndësinë e kryerjes së tyre. – Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve gjatë vjeljes dhe ruajtjes së prodhimeve biologjike bujqësore e blegtorale sipas normave teknike të bujqësisë biologjike. – Mësuesi/Instruktori mund të organizojë vizita mësimore në kultivues të suksesshëm dhe ferma që kultivojnë dhe mbarështrijnë në mënyrë biologjike që nxënësit të shohin dhe të praktikohen në proceset e punës për vjeljen dhe ruajtjen e prodhimeve biologjike bujqësore e blegtorale sipas normave teknike të bujqësisë biologjike. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjetet e mëposhtme: – Mjedise magazinimi të produkteve të bujqësisë biologjike, bimore dhe blegtorale. – Mjedise për ruajtjen e ftohtë të produkteve. – Mjedise për seleksionimin e produkteve të bujqësisë biologjike. – Mjedise për ambalazhimin, paketimin dhe etiketimi e produkteve biologjike. – Ambalazhe ekologjike, materiale paketimi, etiketa dhe logo për produktet e bujqësisë biologjike. – Uniforma e punës. – Vegla të thjeshta dhe të mekanizuara për proceset e pasvjeljes së produkteve biologjike. – Libra, broshura, fletëpalosje, katalogë etj.

5. Moduli “Përpunimi i prodhimeve bimore dhe blegtorale të fermës”

Kualifikimi: Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PËRPUNIMI I PRODHIMEVE BIMORE DHE BLEGTORALE TË FERMËS	M-08-2111-24
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer përpunimin e thjeshtë të drithërave, frutave, perimeve, qumështit dhe mishit në fermë, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike të përpunimit të tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	84 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin profesional “Bujqësi”, Niveli II në KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi/ja përpunon drithërat për miell. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë: – të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës. – të përgatitë vendin e punës për pranimin e drithërave. – të përgatitë mjetet e nevojshme të punës për përpunimin e drithërave. – të pastrojë drithërat për përpunim, sipas metodave të caktuara. – të transportojë në vendin e duhur mbeturinat e pastrimit të drithërave. – të transportojë sasinë e drithërave për bluarje. – të përpunojë drithërat për miell sipas procedurës. – të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë përpunimit të drithërave për miell. – të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përpunimit të drithërave për miell. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Nxënësi/ja përpunon frutat. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë: – të veshë kompletin e punës për përpunimin e frutave. – të përgatitë vendit dhe mjetet e punës për përpunimin e frutave, sipas kërkesave të përcaktuara.	

- të dezinfektojnë enët dhe mjedisin e punës, në përputhje me kërkesat teknike.
- të përzgjedhë llojin e frutave për përpunim, të tilla si: mollë, dardhë, pjeshkë, qershi, etj.
- të përcaktojnë sasisë e frutave për përpunim, sipas kërkesës.
- të përcaktojnë sasisë e sheqerit që do të përdoret në përpunimin e frutave.
- të transportojnë me kujdes sasinë e frutave dhe të sheqerit në mjedisin e përpunimit.
- të përgatitë enët ambalazhuese të produkteve, sipas kërkesës.
- të përgatitë etiketat për ambalazhim me të gjitha të dhënat e duhura.
- të seleksionojnë frutat për përpunim, sipas kritereve, drejtimit të prodhimit dhe kërkesës së tregut.
- të lajë frutat me ujë të rrjedhshëm.
- të përpunojnë frutat për lëngje, komposto, reçel, prevede etj., sipas kërkesës.
- të përgatitë ambalazhin e duhur për mbushjen me produktin e përpunuar, sipas sasisë, kërkesave dhe standardeve për ruajtje.
- të etiketojnë produktin e ambalazhuar sipas rregullit.
- të lajë dhe pastrojnë enët dhe mjetet e tjera të përdorura gjatë përpunimit të frutave.
- të pastrojnë vendin e punës pas përpunimit të frutave, sipas kërkesave higjeno-sanitare.
- të grumbullojnë dhe transportojnë mbeturinat e ndryshme me n duhura dhe në vendin e caktuar.
- të komunikojnë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë përpunimit të frutave.
- të zbatojnë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përpunimit të frutave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi/ja përpunon perimet.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë kompletin e punës për përpunimin e perimeve.
- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e marinadave dhe turshive sipas procedurave standarde.
- të dezinfektojnë enët dhe mjedisin e punës sipas kërkesave higjeno-sanitare.
- të transportojnë me kujdes e pa i dëmtuar perimet në repart.
- të seleksionojnë me kujdes perimet për prodhimin e marinadave dhe turshive.
- të lajë perimet me ujë të rrjedhshëm.
- të heqë pjesët e padobishme të perimeve.

- të përmasojë perimet.
- të blanshirojë perimet sipas kërkesave teknologjike të procesit.
- të transportojë lëndët ndihmëse në repart.
- të përgatisë solucionin e kripës dhe acidit organik në raportet e duhura.
- të grumbullojë e transportojë mbeturinat e ndryshme nga reparti.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë përpunimit të perimeve.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përpunimit të perimeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi/ja përpunon qumështin për konsum dhe nënprodukte.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë kompletin e punës për përpunimin e qumështit.
- të përzgjedhë mjetet e nevojshme të punës për përpunimin e qumështit për konsum dhe për nënprodukte.
- të higjienizojë mjetet dhe i vendin e punës për përpunimin e qumështit për konsum dhe nënprodukte, sipas kushteve higjieno-sanitare.
- të kontrollojë siç duhet, treguesit cilësorë të qumështit për konsum.
- të kontrollojë siç duhet, treguesit cilësorë të qumështit për nënprodukte.
- të transportojë me shumë kujdes, qumështin në rezervuarin (tankun) e grumbullimit.
- të filtrojë sasisë e qumështit sipas procedurës së filtrimit.
- të realizojë përpunimin e qumështit për konsum sipas procedurës së përpunimit.
- të bëjë ambalazhimin e qumështit për konsum dhe ruajtje, sipas kërkesës.
- të përpunojë qumështin për nënprodukte (kos, gjizë, gjalpë, etj) sipas procedurave përkatëse.
- të formojë dhe kripën djathin sipas procedurës përkatëse.
- të ambalazhojë nënproduktet për konsum dhe ruajtje, të prodhuara nga përpunimi i qumështit.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë përpunimit të qumështit për konsum dhe nënprodukte.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përpunimit të qumështit për konsum dhe nënprodukte.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi/ja përpunon mishin për konsum.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë kompletin e punës për përpunimin e mishit.
- të përgatisë vendin e pranimit të shpendëve e kafshëve.
- të higjienizojë mjetet e punës sipas rregullave higjieno-sanitare.
- të lajë kafshët dhe shpendët dhe t'i transportojë ato në vendin e therjes sipas legjislacionit në fuqi.
- të informojë veterinerin zyrtarisht për therjen e kafshës, sipas legjislacionit në fuqi.
- të dezinfektojë mjetet e transportit para dhe pas ngrkimit dhe shkarkimit të kafshëve për në thertore;
- të therë shpendë ose kafshë të tjera sipas procedurës së kryerjes, duke respektuar kërkesat e mirëqënies së kafshëve.
- të transportojë karkasen në vendin e përpunimit me shumë kujdes.
- të varë siç duhet shpendët apo kafshët në konvejer.
- të lajë dhe të dezinfektojë koshat bosh të transportimit të mishit trup të shendëve e të kafshëve.
- të varë kafshët e shpendët pas larjes.
- të largojë pjesët e padobishme nga procesi i therjes.
- të kryejë tualetin e shpendëve dhe të kafshëve pas therjes, sipas procedurës.
- të kryejë ndarjen anatomike të shpendëve e të kafshëve sipas llojit.
- të ambalazhojë mishin trup të shpendëve.
- të ambalazhojë mishin të ndarë në mënyrë anatomike të shpendëve e kafshëve të ndryshme.
- të sistemojë mishin e therur të shpendëve e të kafshëve në re përpunimit termik të ngrirjes.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë përpunimit të mishit për konsum.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë procesit të përpunimit të mishit për konsum.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Nxënësi/ja kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për përpunimin e prodhimeve kryesore bimore dhe blegtorale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të përgatisë fletë kërkesën për bazë materiale.
- të njehsojë kostot e përpunimit të prodhimeve kryesore bimore dhe blegtorale, sipas manualit përkatës.
- të njehsojë preventivin e materialeve dhe koston e tyre,

sipas manualit përkatës.

- të njehsojë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për përpunimin e prodhimeve kryesore bimore dhe blegtorale të fermës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit	– Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në reparte të përpunimit të drithërave, frutave, perimeve dhe produkteve blegtorale si qumësht dhe mish. – Mësimdhënësi i praktikës, ose teknologu i repartit të përpunimit duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve përgatitore për prodhimin nënprodukteve bujqësore e blegtorale, si dhe ambalazhimin e tyre. – Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për prodhimin e nënprodukteve bujqësore e blegtorale, si dhe ambalazhimin e tyre. – Nxënësit duhet të përfshihen në veprimtari konkrete për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike për prodhimin e nënprodukteve bujqësore e blegtorale, si dhe ambalazhimin e tyre. – Mësimdhënësi i praktikës ose teknologu i repartit duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve për përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale. – Mësimdhënësi i praktikës ose teknologu i repartit duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve. – Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për prodhimin e nënprodukteve bujqësore e blegtorale si dhe ambalazhimin e tyre.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme: – Mjedis i përshtatshëm për prodhimin e lëngut, kompostos, reçelit, marmelatës e prevedesë. – Mjedis i përshtatshëm për përpunimin e produkteve blegtorale. – Mjete pune për prodhimin e lëngut, kompostos, reçelit, marmelatës e prevedesë, si dhe ambalazhimin e tyre. – Mjete pune për përpunimin e produkteve blegtorale. – Lëndë të para dhe ndihmëse për prodhimin e nënprodukteve bujqësore e blegtorale. – Pankarta, makete, udhëzues, katalogë, rregullore, standarde

industriale, etj.

- Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e përpunimit të produkteve bujqësore e blegtorale (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

6. Moduli “Kujdesi për mirëqënien dhe shëndetin e kafshëve të fermës”

Kualifikimi: Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KUJDESI PËR MIRËQËNIEN DHE SHËNDETIN E KAFSHËVE TË FERMËS	M-28-2112-24
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të kryer akomodimin e përshtatshëm të kafshëve, të ushqyerit e tyre në lidhje me mirëqënien, si dhe të kujdeset për shëndetin e kafshëve.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin profesional “Bujqësi”, Niveli II në KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi/ja përgatit akomodimin e përshtatshëm për mirëqënien e kafshës. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë: – Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës për kryerjen e shërbimeve. – Të përzgjedhë mjetet dhe vendin për akomodimin e përshtatshëm të kafshës, duke zbatuar kushtet për strehimet e tyre sipas llojit, numrit në grupe, peshës, nevojave të sjelljes. – Të sigurojë hapësirën e nevojshme në përputhje me nevojat fiziologjike dhe etologjike, për mënjanimin e stresit, vuajtjeve dhe dëmtimeve. – Të pastrojë vendqëndrimet e kafshëve sipas llojeve dhe kategorive të kafshëve. – Të pastrojë vendkalimet e kafshëve sipas llojeve dhe kategorive. – Të sigurojë dysheme të pastër, të thatë në vendqëndrimet e kafshëve sipas llojit të shtresave. – Të sigurojë ventilim të mjaftueshëm gjatë gjithë vitit në përputhje me llojin, peshën trupore, numrin e kafshëve. – Të sigurojë ndriçim të mjaftueshëm natural dhe artificial në strehimet e kafshëve. – Të vendosë kafshët në strehime në përputhje me llojin, numrin në grupe, seksit, peshës, nevojave të sjelljes duke mundësuar shoqërizimin me kafshët e të njëjtit lloj. – Të përcaktojë vendin për grumbullimin e mbeturinave.	

-
- Të kujdeset për higjienën e kafshëve dhe t'u sigurojë një zonë të lëvizjes së lirë.
 - Të përdor pajisjet digjitale për monitorimin e parametrave mikroklimatikë në stallë sipas manualeve përkatëse.
 - Të kontrollojë funksionimin e pajisjet mekanike, dhe automatike e digjitale kryesore.
 - Të identifikojë defektet e mosfunksionimit normal të pajiseve.
 - Të komunikojë me etikë e profesionizëm gjatë akomodimit të përshtatshëm lidhur me mirëqënien e kafshëve.
 - Të zbatojë masat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë akomodimit të përshtatshëm lidhur me mirëqënien e kafshëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi/ja kryen të ushqyerit e kafshëve lidhur me mirëqënien e tyre.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës për kryerjen e shërbimeve.
- Të përcaktojë radhën e duhur të punës për të ushqyerin e kafshës/shpendëve.
- Të përzgjedhë llojin e ushqimeve sipas llojit të kafshës dhe shpendëve, peshës e nevojave dhe destinacionit të prodhimit.
- Të kontrollojë rregullisht peshën dhe të përcaktojë llojin e ushqimit shtesë, nëpërmjet balancimit të nevojave të kafshëve dhe shpendëve.
- Të zbatojë normat e racioneve ushqimore sipas llojit, kategorive të kafshëve dhe shpendëve dhe destinacionit të prodhimit.
- Të përdor pajisjet e automatizuara dhe digjitale për ushqyerjen e kafshëve dhe shpendëve sipas manualeve përkatëse.
- Të përdor pajisjet digjitale për të përcaktuar vendndodhjen e kafshëve në kullotë sipas manualeve përkatëse.
- Të përshtasë mënyrën e të ushqyerit në raste të sjelljeve jo normale sipas llojit dhe kategorive të kafshëve dhe shpendëve, si dhe rekomandimeve të specialistëve
- Të plotësojë nevojat e kafshëve me ushqime shtesë në rastet e një ushqimi të pamjaftueshëm.
- Të kontrollojë koritat, pirëset automatike dhe rezervuarët e ujit.
- Të kontrollojë cilësinë e ushqimeve gjatë procesit të të ushqyerit të kafshës.
- Të organizojë të ushqyerit për konsumim të barabartë

ushqimi.

- Të sigurojë furnizimin me ujë në sasi e cilësi në çdo kohë ose sipas programeve të parapërgatitura.
- Të zbatojë rregullat e higjienë s së ujit, mjeteve dhe impianteve të tij, sipas standardeve.
- Të komunikojë me etikë e profesionlizëm gjatë të ushqyerit të përshtatshëm lidhur me mirëqënien e kafshëve.
- Të zbatojë masat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë të ushqyerit të përshtatshëm lidhur me mirëqënien e kafshëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi/ja kujdeset për shëndetin e kafshës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- Të përzgjedhë uniformën e punës për shërbimet që do kryejë.
- Të kontrollojë gjendjen shëndetësore të përgjithshme të kafshëve, të paktën njëherë në ditë.
- Të identifikojë sjelljet e kafshëve dhe shenjat kryesore në këto sjellje si: sjellje seksuale, të mbrojtjes, të ikjes, sjelljes në situata stresuese.
- Të zbatojë kërkesat minimale të mbrojtjes dhe mirëqënies së kafshëve për mbarështimin, prodhimin, përdorimin, shitjen, therjen, eliminimin sipas llojeve dhe kategorive të ndryshme të kafshëve.
- Të zbatojë gjithë masat sanitaro-veterinare për parandalimin e luftimeve midis kafshëve.
- Të zbatojë masat profilaktike të përgjithshme për ruajtjen e shëndetit të kafshëve dhe shpendëve sipas legjislacionit në fuqi.
- Të lejojë trajtimin profilaktik të rregullt dhe ndërhyrjet mjekësore gjatë sëmundjeve apo dëmtimeve.
- Të kryejë vizitat te mjeku veterinar me pasaportën mjekësore duke shënuar vaksinimet dhe mjekimet.
- Të raportojë tek mjeku veterinar treguesit jetësor në rast të sjelljes jonormale të identifikuar.
- Të lejojë ndërhyrjet që shkaktojnë dhimbje dhe vuajtje vetëm me anestezi nga mjeku veterinar.
- Të sigurojë lëvizjen ditore gjatë mbarështimit në mjedis të mbyllura.
- Të kryejë transportin e kafshëve me mjete transporti në kushtet e mirëqënies së kafshëve.
- Të komunikojë me etikë e profesionlizëm.
- Të zbatojë masat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kujdesjes për shëndetin fizik dhe mendor të kafshës në harmoni me mjedisin.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi/ja kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për kujdesin për mirëqenien dhe shëndetin e kafshëve të fermës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të përgatisin fletë kërkesën për bazë materiale.
- të njehsojnë kostot e kujdesit për mirëqenien dhe shëndetin të kafshëve të fermës, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogarisin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për kujdesin për mirëqenien dhe shëndetin e kafshëve të fermës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës dhe territore të tjera të përshtatshme pranë shkollës.
- Mësimdhënësi mund të organizojë edhe vizita në ferma blegtorale të cilat mbarështojnë kafshë në rregjim stallor.
- Mësimdhënësi duhet të demonstrojë veprimtari konkrete pune për shërbime kujdesi për kafshë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për shërbime kujdesi që lidhen në mirëqenien e kafshëve në fillim në mënyrë të mbikqyrur e pastaj në mënyrë të pavarur.
- Nxënësit duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryhen gjatë akomodimit, të ushqyerit të kafshëve dhe kujdesit për shëndetin e kafshëve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për njohuritë e marra për realizimin e proceseve të punës për shërbime kujdesi që lidhen me mirëqenien dhe shëndetin e kafshëve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Baza prodhuese e shkollës ose fermë ku rriten kafshë.
 - Pajisje dhe vegla pune për shërbimet ndaj kafshëve, lopata, çfurçe, karroca dore, kova uji, makineri e paisje për largimin e plehut.
 - Paisje digjitale për matjen parametrave shëndetësore dhe
-

riprodhues,

- Paisjet të automatizuara dhe digjitale për ushqyerjen kafshëve dhe shpendë ve
 - Paisjet digjitale për të përcaktuar vendndodhjen e kafshëve në kullotë
 - Korita, lugje uji, pirëse automatike.
 - Ushqime të ndryshme sipas llojit dhe nevojave të kafshëve, katalogje ushqimesh.
 - Tabela me nevojat ushqimore të kafshëve.
 - Komplet i veglave, paisjeve dhe materialeve për mjeljen mekanike, paisje për pastrimin e kafshës.
 - Mjete ndihmëse vizuale.
-

7. Moduli “Kujdesi për kafshët dhe higjienën gjatë mbarështimit të tyre”

Kualifikimi: Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	KUJDESI PËR KAFSHËT DHE HIGJENËN GJATË MBARËSHTIMIT TË TYRE	M-14-2113-24
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të kontrolluar standardet higjienike në komplekset blegtorale, higjienën e prodhimit dhe magazinimit të ushqimit, higjienën e ujit dhe impiantëve të ujit, higjienën e mjeljes dhe impiantëve të mjeljes në kafshëve bujqësore të fermës.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin profesional “Bujqësi”, Niveli II në KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi/ja kontrollon standardet higjienike të kompleksit blegtoral. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë: – të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë kontrollit të standardeve higjienike të kompleksit blegtoral; – të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për kontrollin e standardeve higjienike të kompleksit blegtoral; – të kontrollojë kushtet higjieno-sanitare brenda dhe jashtë fermave blegtorale, sipas regullave të caktuara; – të kontrollojë higjienën e përgjithshme të tufës së kafshëve; – të vlerësojë parametrat higjienik dhe sasior të ujit në stallë; – të zbatojë rregullat e higjienës të ujit, mjeteve dhe impianteve të tij, sipas standardeve; – të kontrollojë përdorimin e detergjentëve, dezinfektantëve dhe të pastruesve të lejuar, sipas udhëzuesve të përdorimit – të grumbullojë dhe manaxhojë jashtëqitjet e kafshëve, duke respektuar mjedisin – të vlerësojë parametrat përbërës të stallës blegtorale; – të kontrollojë dhe vlerësojë parametrat e mikroklimës në stallë sipas llojit të kafshës, kategorisë, gjinisë dhe gjendjes fiziologjike; – të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup; – të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;	

- të pastrojë dhe sistemojë vendin punës pas kontrollit të standardeve higjienike;
- të zbatojë saktë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit të standardeve higjienike të kompleksit blegtoral;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë

RN 2 Nxënësi/ja kryen kontrollin e të ushqyerit e kafshëve bujqësore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse personale;
- të përcaktojë radhën e duhur të punës për të ushqyerin e kafshës;
- të përzgjedhë llojin e ushqimeve sipas llojit dhe nevojave të kafshës;
- të kontrollojë në mënyrë periodike ushqimin dhe vend magazinimin e ushqimit të blegtorisë;
- të identifikojë problemet që mund të kenë ushqimet e njoma, cilësia e silazhit dhe ushqimi peletuar;
- të kontrollojë koritat, pirëset automatike dhe rezervuarët e ujit;
- të kontrollojë cilësinë e ushqimeve gjatë procesit të të ushqyerit të kafshës;
- të organizojë të ushqyerit për konsumim të barabartë ushqimi.
- të sigurojë furnizimin me ujë në sasi e cilësi në çdo kohë sipas programeve të parapërgatitura.
- të ushqejë kafshët (të trasha dhe/ose të imta), sipas kategorive të qëllimit të mbarështimit të tyre;
- të ushqejë shpendë sipas drejtimit të prodhimit;
- të ushqejë të porsalindur në lloje të ndryshme kafshës bujqësore;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin punës pas ushqyerjes së kafshëve;
- të zbatojë saktë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë ushqyerjes së kafshëve

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë

RN 3 Nxënësi/ja kujdeset për sigurimin dhe higjienën e ujit, pirëseve dhe impianteve të ujit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse personale.
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për kontrollin e standardeve higjienike të ujit, pirëseve dhe impjanteve të ujit.
- të sigurojë hapësirën e mjaftueshme për pirjen e ujit nga kafshët dhe shpendët, sipas llojit dhe kategorisë.
- të sigurojë ujë në sasi, cilësi dhe pozicion të përshtatshëm, sipas llojit dhe kategorisë
- të kontrollojë temperaturën, shijen dhe aromën e ujit.
- të kontrollojë burimin/pusin, dhe pirëset për ndotje (ushqim ose pleh).
- të kontrollojë në mënyrë periodike ujin, depozitat dhe rrjetin e ujit.
- të identifikojë problemet e pamjaftueshmërisë së ujit në pirëse dhe sistemin e shpërnadrjes së ujit.
- të zbatojë procedurat e higjenizimit të depozitave, rrjetit dhe impjanteve të ujit me dezinfektant të përshtatshëm sipas standardeve.
- të zbatojë procedurat e kontrollit të cilësisë së ujit një herë në vit, për ngarkesa bakteriale, Ph, nitrite etj.
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- të pastrojë dhe sistemojë vendin punës pas sigurimit të ujit për kafshet dhe shpendët.
- të zbatojë saktë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë sigurimit dhe higjienës së ujit dhe impiantit të ujit për kafshët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë

RN 4 Nxënësi/ja kujdeset për higjienën gjatë mjeljes së kafshëve të fermës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës;
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik gjatë përgatitjes së kafshëve të fermës për mjelje, si dhe të sigurojë qetësi në stallë;
- të sigurojë higjienën personale, para fillimit të mjeljes së kafshëve të fermës;
- të higjenizojë pajisjet dhe enët që do të përdoren për mjelje dhe mbajtjen e qumështit, duken i larë dhe shpëlarë me ujë të rrjedhshëm ato;
- të zbatojë parimet kryesore të mjeljes si: pastërtia, qetësia, kontrolli, vazhdimësia e mjeljes dhe rregullësia e

mjeljes.

- të përgatitësë, siç duhet, mjetet që nevojiten për pastrimin, larjen dhe masazhimin e gjirit të kafshëve të fermës.
- të kontrolloje përdorimin e detergjentëve, dezinfektantëve dhe pastruesve të lejuar për procesin e mjeljes.
- të bëjë pastrimin e gjirit të kafshës para mjeljes
- të kontrolloje procesin e mjeljes sipas standardeve të higjienës.
- të përdor pajisjet e automatizuara dhe digjitale për mjeljen e kafshëve, sipas manualeve përkatëse.
- të zbatojë procedurat e pastrimit të impiantëve mjelëse, enëve apo pajisjeve të qumështit, sipas manualeve dhe standardeve të higjienës.
- të mbajë saktë shënimet përkatëse për punën e kryer.
- të zbatojë drejt masat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për pastrimin dhe larjen e gjirit të kafshëve.
- të kontrollojë aparatin mjelës sipas kritereve të punës;
- të vendosë gotat mjelëse me saktësi në thithat e gjirit, duke vënë aparatin në pozicionin e duhur;
- të vendosë në gjendje pune aparatin mjelës;
- të vrojtojë e kontrollojë daljen e qumështit derisa të përfundojë mjelja;
- të bëjë ndalimin e punës së aparatit mjelës, në momentin e përfundimit të mjeljes;
- të heqë gotat mjelëse me kujdes, nga thithat e gjirit të kafshës;
- të fërkojë me pece të pastër gjirin dhe të shtrydhë pikat e fundit;
- të transportojë me kujdes qumështin në dhomën e përpunimit;
- të pastrojë, siç duhet, enët dhe aparatin mjelës pas përdorimit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mjeljes mekanike të kafshëve bujqësore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë

RN 5 Nxënësi/ja kujdeset për kafshët gjatë pjelljes dhe për të porsalindurit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës;
- të realizojë me korrektësi radhën e përgatitjes për punë;
- të përcaktojë, nëpërmjet regjistrave, datën e pjelljes së kafshës;
- të dallojë shenjat e afrimit të pjelljes;
- të kontrollojë gjendjen e gjirit në muajin e fundit të

- mbarsmërisë në kafshë;
- të përcaktojë saktë një lindje normale dhe jo normale;
- të përcaktojë saktë peshën e të porsalindurve;
- të trajtojë kafshën pas procesit të pjelljes nga ana higjienike dhe ushqimore;
- të trajtojë të porsalindurit nga ana higjienike dhe ushqimore;
- të zbatojë masat e ndihmës dhe të kujdesit për të porsalindurin;
- të realizojë dhënien e kulloshtres së parë, në sasinë dhe cilësi e duhur;
- të kryejë trajtimin e të porsalindurve në mjedise të veçanta si bokse, në profilaktor, në stalla etj.
- të regjistrojë të dhëna dhe operacionet e punës në fermën e kafshëve bujqësore.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kujdesit për kafshët gjatë pjelljes dhe për të porsalindurve.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kujdesit për kafshët gjatë pjelljes dhe për të porsalindurve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Nxënësi/ja kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për kujdesin për mirëqenien dhe shëndetin e kafshëve të fermës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të përgatisin fletë kërkesën për bazë materiale.
- të njehsojnë kostot e kujdesit për kujdesin për kafshët gjatë pjelljes dhe për të porsalindurin, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogarisin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për kujdesin për kafshët gjatë pjelljes dhe për të porsalindurin.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në territorin e fermës së shkollës dhe territore të tjera të përshtatshme pranë shkollës.
- Mësuesi/instruktori mund të organizojë edhe vizita në ferma blegtorale të cilat mbarështojnë kafshë me regjim stallor dhe kullosor.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të metodave të higjienizimit të komplekseve blegtorale, higjienizimit të proceseve të punës për mjeljen e kafshëve të fermës kontrollit të ushqimeve, ujit dhe paisjeve të tyre, trajtimin e kafshëve gjatë pjelljes dhe për të

	porsalindurin, për të identifikuar kushtet higjienike, si dhe të asistojë në procesin e pjelljes së kafshëve në bazën prodhuese të shkollës dhe ekonomi blegtorale. – Instruktori duhet të përdorë tekste standarde dhe manuale që kanë të bëjnë me metodat e kontrollit dhe mjeljes së kafshëve vlerësimin të ushqimit dhe ujit të kafshëve të fermës dhe përshtatshmëria për lloje të ndryshme kafshësh. – Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kontrollin e parametrave higjienik të stallave, vlerësimin e parametrave higjienik të mjeljes, impianteve të ushqimit dhe ujit, si dhe pajisjeve të mjeljes, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. – Gjatë vlerësimin të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për njohuritë e marra për higjienën e proceseve prodhuese në blegtori. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme: – Fermë blegtorale – Tokë kullosorë, punishte ushqimi. – Magazinë ushqimi, depo silazhi. – Tabela analitike të ushqimeve. – Tabela për nevojat ushqimorë të kafshëve. – Mjete të tjera vizuale. – Manuale praktike për të ushqyerin e kafshëve. – Katalogje ushqimesh – Enë uje dhe paisje të atomatizuara – Dezinfektat, detergjent, – Kova, bidona, enë qumështi – Makina mjelëse etj.

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

1. Moduli “Mbrotjtja e integruar në bujqësi”

Kualifikimi: Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	MBROJTJA E INTEGRUAR NË BUJQËSI	M-14-1956-24
Qëllimi i modulit	Modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të organizuar punën, kryer kontrollin fushor, si dhe zbatuar planin e masave të menaxhimit të integruar të dëmtuesve me qëllim mbrojtjen e integruar të kulturave bujqësore në fermë.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin profesional “Bujqësi”, Niveli II në KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi/ja kryen kontroll fushor. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë: – të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë kryerjes së kontrollit fushor. – të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për kryerjen e kontrollit fushor. – të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës për kryerjen e kontrollit fushor. – të përcaktojë saktë qëllimin e kontrollit fushor: për dëmtues, sëmundje apo barëra të egra. – të përzgjedhë llojin e kulturës; bimë arash, perime, drufrutorë etj., dhe e parcelave për kontroll. – të hartojë planin e vrojtimit për një parcelë të dhënë, duke përfshirë datat dhe kohën e saktë të kryerjes së vrojtimit. – të përcaktojë fazën biologjike të kulturës sipas karakteristikave të rritjes normale. – të identifikojë bimët e infektuara në parcelë sipas karakteristikave të rritjes jo normale të tyre. – të diagnostikojë saktë shkakun e infeksionit: dëmtues, sëmundje apo barëra të egra. – të përcaktojë shkallën e infeksionit nëse është në rritje apo në rënie. – të bëjë vlerësimin e përgjithshëm të gjendjes së kulturës. – të realizojë me korrektësi planin e kontrollit fushor duke

-
- respektuar datat dhe kohën e vrojtimit.
 - të mbajë saktë shënimet për parcelën e monitoruar lidhur me bimët dhe dëmtuesit.
 - të plotësojë saktë dokumentacionin përkatës të kontrollit fushor.
 - të analizojë të dhënat për të përcaktuar dëmin ekonomik të shkaktuar nga infektimet të ndryshme.
 - të krahasojë gjendjen aktuale të kulturës së përzgjedhur me standardin e lejuar ekonomik (pragu ekonomik) për të ndërhyrë për mbrojtjen e tyre.
 - të raportojë (të bëjë me dije) të dhënat e kontrollit fushor në instanca më të larta përgjegjëse për marrjen e masave të kontrollit.
 - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë kryerjes së kontrollit fushor.
 - të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së kontrollit fushor.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi/ja zbaton masat e mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga dëmtuesit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga dëmtuesit.
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për zbatimin e masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga dëmtuesit.
- të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës për zbatimin e masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga dëmtuesit.
- të zbatojë masat agroteknike të mbrojtjes së kulturave ndaj dëmtuesve, të tilla si: pastrimi dhe higjienizimi i vendit apo zonës së infektuar, punimi i tokës, mbjellja e varieteteve rezistente nga dëmtuesve, qarkullimi bujqësor, bashkëshoqërimi i kulturave bujqësore etj.
- të zbatojë masat biologjike të mbrojtjes së kulturave ndaj dëmtuesve, të tilla si: kujdesi për ruajtjen e “grabitqarëve” të dëmtuesve, përdorimi i insekticideve selektive që janë pak ose aspak të dëmshëm ndaj këtyre “grabitqarëve”, shfrytëzimi i “grabitqarëve” natyror etj.
- të zbatojë masat fiziko-mekanike të mbrojtjes së kulturave ndaj dëmtuesve, të tilla si: përdorimi i metodës së ftohtë apo të nxehtë, për vrasjen e dëmtuesve apo ngadalësimin e rritjes, përdorimi i rrjetave të posaçme apo grackave për kapjen e dëmtuesve etj.,
- të zbatojë masat kimike të mbrojtjes së kulturave ndaj

dëmtuesve: përdorimi i feromoneve, përdorimi i rregullatorëve të rritjes së insekteve dhe dëmtuesve, përdorimi i sterilizantëve etj.

- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga dëmtuesit.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga dëmtuesit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi/ja zbaton masat e mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga sëmundjet.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse për zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga sëmundjet.
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për zbatimin e masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga sëmundjet.
- të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës për zbatimin e masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga sëmundjet.
- të zbatojë masat agroteknike të mbrojtjes së kulturave ndaj sëmundjeve, të tilla si: mbajtja e tokës ugar, largimi i barërave të egra, pastrimi dhe higjienizimi i vendit apo zonës me bimë të infektuara, mbjellja e varieteteve rezistente nga sëmundjeve, qarkullimi bujqësor i kulturave, heqja me dorë e bimëve apo pjesëve të tyre të prekura nga sëmundje të ndryshme etj.
- të zbatojë masat biologjike të mbrojtjes së kulturave ndaj sëmundjeve, të tilla si: përdorimi i organizmave antagonist me sëmundjen, përdorimi i teknikave të tërthorta të mbrojtjes për viruset etj.,
- të zbatojë masat fiziko-mekanike të mbrojtjes së kulturave ndaj sëmundjeve, të tilla si: trajtimi i bimëve apo i pjesëve të tyre me nxehtësi, përdorimi i metodave specifike të ruajtjes dhe trajtimit të bimëve dhe produkteve bimore etj.
- të zbatojë masat kimike të mbrojtjes së kulturave ndaj sëmundjeve, të tilla si: përdorimi i preparateve kimike për mbrojtjen e bimës mbartëse përpara infektimit, përdorimi i pesticideve, përdorimi i preparateve organike specifike për trajtimin e sëmundjeve të shkatuara nga bakteret, viruset, nematodat etj..
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga sëmundjet.

- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga sëmundjet.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Nxënësi/ja zbaton masat e mbrojtjes së bimëve nga barërat e egra.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së bimëve nga barërat e egra.
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për zbatimin e masave të mbrojtjes së bimëve nga barërat e egra.
- të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave, mjeteve të punës për gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së bimëve nga barërat e egra.
- të zbatojë masat agroteknike të mbrojtjes së kulturave ndaj barërave të këqija, të tilla si: shkulja me dorë e barishteve të egra, shkulja me anë të prashitjeve e barishteve të egra, lesimi i tokës, përdorimi i farës së pastër nga farërat e barishteve, mbjellja e kulturave konkurruese ndaj barërave të egra, qarkullimi i kulturave bujqësore, bashkëshoqërimi i kulturave etj..
- të zbatojë masat kimike të mbrojtjes së kulturave ndaj barishtet e egra, të tilla si: përdorimi i herbicideve selektive sipas llojit dhe fazës së zhvillimit të bimës etj., përdorimi i herbicideve jo selektive, përdorimi i herbicideve të lokalizuara (për gjethë, kërcell etj.).
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së bimëve nga barërat e këqija.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së bimëve nga barërat e këqija.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi/ja kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për menaxhimin e integruar të dëmtuesve në bujqësi.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të përgatisë fletë kërkesën për bazë materiale.
- të njehsojë kostot për mbrojtjen e integruar të dëmtuesve në bujqësi.
- të njehsojë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.

- të njehsojë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në mbrojtjen e integruar të dëmtuesve në bujqësi.
- të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë vlerësimit të tokës për kryerjen e kontrollit fushor.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me punimet e kryera.
- të llogarisë koston e zbatimit të masave të mbrojtjes së bimëve nga dëmtuesit.
- të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga dëmtuesit.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me punimet e kryera.
- të llogarisë koston e zbatimit të masave të mbrojtjes së bimëve nga sëmundjet.
- të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga sëmundjet.
- të llogarisë koston e zbatimit të masave të mbrojtjes së bimëve nga barërat e egra.
- të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së bimëve nga barërat e egra.
- të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul mund të trajtohet në fermën e shkollës, në ferma të tjera pranë shkollës sipas mundësive që ofron zona apo rajoni ku ndodhet shkolla.
- Gjatë trajtimit të modulit mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë demostrime konkrete të kryerjes së veprimtarive të organizimit të planit të punës, kryerjes së kontrollit të fushave të mbjella, si dhe për zbatimin e planit të masave të mbrojtjes së integruar në bujqësi kundër dëmtuesve, sëmundjeve dhe barërave të egra.
- Mësimdhënësi mund të organizojë vizita mësimore apo takime me eksperte bujqësie për shkëmbimin e përvojave mbi organizimin e planit të punës, kryerjes së kontrollit të fushave të mbjella, si dhe zbatimin e planit të masave të mbrojtjes së integruar në bujqësi kundër dëmtuesve, sëmundjeve dhe barërave të egra, në familiaritet me mjedisin.
- Nxënësit duhet të praktikohen sa më shumë të jetë mundur në kryerjen e veprimtarive të organizimit të planit të punës, kryerjes së kontrollit të fushave të mbjella, si për zbatimin e planit të masave të mbrojtjes së integruar në bujqësi kundër

	dëmtuesve, sëmundjeve dhe barërave të egra. – Mëismdhënësi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zbatimit të planit të masave të mbrojtjes së integruar në bujqësi. – Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të organizimit të planit të punës, kryerjes së kontrollit të fushave të mbjella, si dhe të zbatimit të planit të masave të mbrojtjes së integruar në bujqësi kundër dëmtuesve, sëmundjeve dhe barërave të egra.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme: – Ferma e shkollës. – Pajisje kancelarie. – Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos. – Përmbledhje e legjislacionit në fushën e shërbimeve që lidhet me përdorimin e preparateve kimike në bujqësinë/fermat organike (kodi i punës, legjislacioni fiskal). – Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.

2. Moduli “Ujitja e bimëve të arave dhe perimeve”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	UJITJA E BIMËVE TË ARAVE DHE PERIMEVE	M-14-947-24
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për kryerjen e ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika, si dhe për llogaritjet e thjeshta ekonomike lidhur me kryerjen e ujitjeve në bimët e arave dhe perimeve në fermë.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin profesional “Bujqësi”, Niveli II në KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi/ja kryejnë punime përgatitore për ujitjen me mënyra të ndryshme. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë: – të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës. – të përzgjedhën veglat, pajisjet për kryerjen e ujitjeve sipas kulturës dhe mënyrës së ujitjes. – të përcaktojnë sipërfaqen e mbjellë për ujitje sipas kulturave. – të transportojë veglat dhe pajisjet në vendin e caktuar. – të interpretojnë skemat për ujitjen e tokës. – të përcaktojnë mënyrën e duhur të ujitjes sipas llojit të kulturës dhe tipit të tokës bujqësore. – të kontrollojnë gjendjen teknike të rrjetit ujitës përpara fillimit të ujitjes. – të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë kryerjes së proceseve të punës për përgatitjen për ujitjen e kulturave bujqësore. – të zbatojnë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë gjatë kryerjes së proceseve të punës për përgatitjen për ujitjen e kulturave bujqësore. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Nxënësi/ja kryejnë ujitje sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje. Kriteret e vlerësimit:	

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- të përcaktojë kulturën që i përshtatet ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.
- të përcaktojë gjerësinë dhe largësinë e brazdave sipas llojit të tokës.
- të hapë brazdat duke zbatuar parametrat teknikë sipas përbërjes mekanike, pjerrësisë së tokës, llojit të kulturës etj.
- të lëshojë ujin në brazdë me një rrymë fillestare të caktuar për të mbërritur sa më shpejt në fund të saj.
- të përcaktojë kohën e qëndrimit të ujit në brazdë sipas përbërjes grimcametrike të tokës dhe kërkesave të bimës.
- të ndjekë lëvizjen e ujit në brazdë sipas drejtimit të rrjeshtave të bimëve.
- të kryejë ujitjen sipërfaqësore me rrëshqitje sipas pjerrësisë së tokës.
- të kontrollojë cilësinë e ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje për plotësimin e kërkesave teknike.
- të pastrojë dhe ruajnë veglat dhe pajisjet për ujitjen sipërfaqësore me brazda dhe rrëshqitje.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë kryerjes së kryerjes së proceseve të punës gjatë ujitje sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë ujitje sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN3 Nxënësi/ja kryejnë ujitjen me shihedhje.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- të përzgjedhë kulturën që i përshtatet ujitjes me shihedhje.
- të kontrollojë impiantin shihedhës për funksionim të rregullt të tij.
- të montojë impiantin ujitës sipas kërkesave teknike.
- të lëshojë ujin në mënyrë të njëtrajtshme për mbulimin e të gjithë sipërfaqes.
- të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme kryerjen e ujitjes për evitimin e rrjedhjeve nga tubacionet.
- të ndalojë ujin në impiantin ujitës me shihedhje duke garantuar mos rrjedhjen e tij.
- të çmontojë impiantin ujitës sipas kërkesave teknike.
- të pastrojë dhe mirëmbajnë impiantin ujitës sipas

kërkesave teknike.

- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë kryerjes së kryerjes së proceseve të punës gjatë ujitjes me shihedhje.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë ujitje me shihedhje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Nxënësi/ja kryejnë ujitjen me pika.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- të përzgjedhë kulturën që i përshtatet ujitjes me pika.
- të përzgjedhë pikatoret e duhura në varësi të kulturës dhe t'i transportojë ato.
- të montojë pikatoret në tubacione sipas kushteve teknike.
- të përcaktojë normën e ujitjes sipas formulës së dhënë.
- të lëshojë ujin në mënyrë të njëtrajtshme për mbulimin e të gjithë sipërfaqes.
- të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme ujitjen me pika për evitimin e rrjedhjeve nga tubacionet.
- të ndalojë ujin në impiantitin ujitës me pika duke garantuar mos rrjedhjen e tij.
- të çmontojë tubat e çmontueshëm dhe pikatoret sipas kushteve teknike.
- të pastrojë dhe mirëmbajnë pikatoret sipas kërkesave teknike.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë kryerjes së kryerjes së proceseve të punës gjatë ujitjes me pika.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë ujitjes me pika.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi/ja kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për ujitjen me mënyra të ndryshme të bimëve të arave dhe perimeve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të përgatisë fletë kërkesën për bazë materiale.
- të njehsojë kostot e kryerjes së ujitjes sipërfaqësore me brazda, me shihedhje dhe me pika, sipas manualit përkatës.
- të krahasojë kostot e mënyrave të ndryshme të ujitjes.
- të njehsojë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet

shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.

- të njehsojë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për kryerjen e ujitjes sipërfaqësore me brazda, me shihedhje dhe me pika.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës ose ferma bujqësore ku kultivohen bimë arash dhe perime.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për ujitjen sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika.
- Nxënësit duhet të përfshihen në veprimtari konkrete për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike për ujitjen sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe impjanteve për ujitjen sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave, pajisjeve dhe impjanteve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për ujitjen sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika si dhe për llogaritje të thjeshta ekonomike.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen terreni, veglat dhe pajisjet e punës të mëposhtme:
- Skica të gatshme me skema për rrjetin e ujitjes sipërfaqësore me brazda, me shihedhje dhe me pika.
 - Impiant për ujitjen me shihedhje dhe me pika, tubacione, etj.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e hapjes së kanaleve ujitëse (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

3. Moduli “Përpunimi dhe ruajtja e ushqimeve foragjere për blegtorinë ”

Kualifikimi: Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PËRPUNIMI DHE RUAJTJA E USHQIMEVE FORAGJERE PËR BLEGTORINË	M-14-2114-24
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për mënyrën e përgatitjes, manipulimit, ruajtjes dhe konservimit të ushqimeve foragjere për blegtorinë si: përgatitja e barit të thatë, silazhit, bluarjen shtypjen, coptimin e drithërave, magazinimin e ushqimeve foragjere për blegtorinë, si dhe llogartje të thjeshta ekonomike lidhur me përpunimin dhe ruajtjen e ushqimeve foragjere për blegtorinë.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin profesional “Bujqësi”, Niveli II në KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi/ja përgatit sanë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë: – të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punë për përgatitjen e sanës. – të përgatitë siç duhet veglat për përgatitjen e sanës: drapër, kosë e të tjera materiale ndihmëse. – të përcaktojë fushën/zonën ku do të kryhet prerja/ korrja foragjereve për përgatitjen e sanës, sipas kriterëve të duhura. – të përcaktojë saktë kohën e korrjes së foragjereve për sanë. – të transportojë me kujdes veglat në vendin e përcaktuar. – të bëjë me kujdes pastrimin e fushës nga objekte të forta apo mbeturina të tjera. – të largojë me kujdes mbeturinat nga fusha e caktuar për korrje. – të kryejë prerjen e foragjereve me drapër ose me kosë sipas kriterëve përkatëse. – të përgatitë siç duhet kompletin e veshjes së përshtatshme për tharjen e foragjereve. – të përgatitë siç duhet veglat për tharjen e foragjereve: drapër, kosë, cfurk e materiale ndihmëse. – të shpërndajë siç duhet foragjeret e korrura duke përdorur	

-
- vegla krahu si cfurk etj.
- të kthejë sipas rregullit foragjeret me cfurk ose me mjete të mekanizuara.
 - të mbledhë foragjeret në grumbuj sipas rregullit dhe në kohën e duhur.
 - të rishpërndajë foragjeret sipas rregullit dhe në kohën e duhur.
 - të rikthejë foragjeret për tharje sipas rregullit.
 - të kryejë vazhdimisht kontrollin organoleptik të cilësisë së foragjereve gjatë tharjes.
 - të ngarkojë me shumë kujdes sanën në mjetet e transportit.
 - të kujdeset për ruajtjen e sanës, për të siguruar cilësinë e tyre, sipas parametrave të përcaktuara.
 - të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës përgatitjes së sanës.
 - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së operacioneve të punës për përgatitjen e sanës.
 - të zbatojë siç duhet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së sanës.
 - të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës pas përgatitjes së sanës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN2 Nxënësi/ja kryen silazhimin e ushqimeve foragjere.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të përgatitë siç duhet kompletin e veshjes së përshtatshme për prerjen/korrjen e ushqimeve foragjere.
- të përcaktojnë kulturën që përshtatet për silazhim.
- të përcaktojnë momentin e korrjes së kulturave sipas stadit të vegjetacionit për përgatitjen e silazhit.
- të grijë foragjeret sipas standardit përkatës.
- të përgatisë gropën e silazhit, sipas standardeve teknike.
- të transportojë me mjetet e duhura, masën foragjere të grirë në gropën e silazhit.
- të kryejë ngjeshjen (shtypjen) e masës foragjere të grirë në gropën e silazhit.
- të shtojë aditivët ndihmës sipas normave teknike.
- të kryejë mbylljen hermetike të gropës së silazhit.
- të përcaktojë kohën e hapjes së gropës së silazhit sipas kulturave foragjere.
- të kryejë prerjen e masës së silazhit sic duhet dhe në të gjithë gjerësinë e saj.
- të garantojë cilësinë e silazhit.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së operacioneve të punës për përgatitjen e silazhit.

- të zbatojë siç duhet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së operacioneve të punës për përgatitjen e silazhit.
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës gjatë kryerjes së operacioneve të punës për përgatitjen e silazhit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje-përgjigje me gojë

RN3 Nxënësi/ja përgatit ushqime të koncentruara për blegtorinë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të përgatitë siç duhet veglat, makineritë dhe pajisjet për përgatitjen e ushqimeve të koncentruara për blegtorinë.
- të përcaktojë madhësinë e copëtimit të ushqimeve sipas llojit dhe kategorisë së kafshëve dhe kriterëve të duhura.
- të përcaktojë saktë kohën e korrijës së kulturave për përgatitjen e ushqimeve të koncentruara për blegtorinë
- të transportojë me shumë kujdes ushqimet e koncentruara në vendet e ruajtjes.
- të magazinonjë ushqimet e koncentruara në ambiente pa lagështi dhe të ajrosura mirë.
- të ruajë ushqimet e koncentruara në thasë duke i vendosur jo direkt mbi dysheme, por mbi një shtresë dërrase.
- të stivosë thasët njëri-mbi tjetrin, 6-7 thasë.
- të bëjë me shumë kujdes pastrimin, dezisektimin, deratizimin e fushës/ vendit të ruajtjes së ushqimeve të koncentruara.
- të largojë me kujdes mbeturinat nga fusha/depot e ruajtjes së ushqimeve të koncentruara.
- të kryejë vazhdimisht kontrollin organoleptik të cilësisë së ushqimeve të koncentruara.
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës pas përgatitjes së ushqimeve të koncentruara.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë përgatitjes së ushqimeve të koncentruara për blegtorinë.
- të zbatojë siç duhet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së ushqimeve të koncentruara për blegtorinë.
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës pas përgatitjes së ushqimeve të koncentruara për blegtorinë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje- përgjigje me gojë

RN 4 Nxënësi/ja kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për përpunimin dhe ruajtjen e ushqimeve foragjere për

blegtorinë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të përgatisë fletë kërkesën për bazë materiale.
- të njehsojë kostot e kryerjes së përpunimit dhe ruajtjes së ushqimeve foragjere për blegtorinë, sipas manualit përkatës.
- të krahasojë kostot e mënyrave të ndryshme të ujitjes.
- të njehsojë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për përpunimin dhe ruajtjen e ushqimeve foragjere për blegtorinë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës ose në parcela të mbjella pranë shkollës, magazinat e ushqimeve të koncentruara dhe silose.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për përgatitjen e sanës, për përgatitjen e silazhit, përgatitjen e ushqimeve të koncentruara, si dhe për llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me këto procese pune.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë të jetë e mundur në demonstrimet konkrete për përgatitjen e sanës, për përgatitjen e silazhit, përgatitjen e ushqimeve të koncentruara, si dhe për llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me këto procese pune.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve për korrrjen, mbledhjen transportimin, ngjeshjen e foragjereve për silazh si dhe për bluarjen, coptimin dhe magazinimin e drithrave.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave, pajisjeve dhe makinerive për përpunimin dhe ruajtjen e ushqimeve foragjere për blegtorinë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për njohurit e marra për përgatitjen manipulimin ruajtjen dhe konservimin e ushqimeve foragjere.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen fermë bujqësorë, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Sipërfaqe e mbjellë me bar dhe jonxhë, misër, lolium tërshër etj.
 - Kosë, drapër, makina korrese.
-

-
- Komplet i veshjes.
 - Sillose.
 - Drithra si: misër tërshërë, elb, sojë etj..
 - Aditivë ushqimorë.
 - Manuale ose katalogje për operacionet e punës për tharjen e barit.
 - Video të proceseve të punës gjatë korrjes, kthimit, grumbullimit, si dhe të transportit të barit të thatë dhe të jonxhës.
 - Video të proceseve të punës gjatë korrjes, transportit të foragjereve, grumbullimit, ngjeshjes, si dhe përgatitjes së siloseve.
 - Video të proceseve të punës gjatë korrjes, transportit, grumbullimit, copëtimit dhe blurjes së drithrave,
-

4.Moduli: “Përdorimi i digjitalizimit për menaxhimin e fermës”

Kualifikimi: Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PËRDORIMI I DIGJITALIZIMIT PËR MENAXHIMIN E FERMËS	M-19-2115-24
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të përdorur mjetet digjitale në bujqësi për rritjen e efikasitetit të teknologjive bujqësore dhe përmirësimin e prodhimit bujqësor	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin profesional “Bujqësi”, Niveli II në KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi/ja përzgjedh mjetet digjitale dhe aplikacionet që përdoren në bujqësi. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë: – të përcaktojë mjetet digjitale për menaxhimin e fermës (kompjuter, smartphone, dronët dhe paisje të tjera kompjuterike). – të identifikojë aplikacionet e mjeteve digjitale që përdoren në bujqësi dhe mënyrat e përdorimit të tyre (software, sensorë etj.). – të përcaktojë mjetet digjitale sipas proceseve të punës që do ndiqen. – të interpretojë manualët, katalogët dhe udhëzuesit e përdorimit të mjeteve digjitale në bujqësi. – të sigurojë vendosjen e përshtatshme të tyre në vende të caktuara. – të përcaktojë radhën e përgatitjes dhe vënien në punë të tyre duke ndjekur specifikimet teknike. – të përzgjedhë paisje digjitale të përshtatshme sipas parametrave të kontrollit e monitorimit. – të sigurojë furnizimin e mjeteve digjitale me energji dhe lidhjen e përshtatshme të tyre. – të përdorë mjetet digjitale në funksion të proceseve të punës. – të tregojë kujdesin e duhur për mirëmbajtjen e tyre. – të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë përzgjedhjes me mjetet digjitale që përdoren në bujqësi.	

-
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përzgjedhjes me mjetet digjitale që përdoren në bujqësi.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli..

RN 2 Nxënësi/ja instalon mjetet digjitale në bujqësi sipas përdorimit të tyre.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të instalojë programe digjitale të thjeshta për informacionin e tokës bujqësore.
- të instalojë pajisjet digjitale të thjeshta për kontrollin e sistemeve të ujitjes me pika dhe me precizion.
- të instalojë pajisjet digjitale për monitorimin e dëmtuesve të bimëve.
- të instalojë pajisjet digjitale për plehërimin e bimëve.
- të instalojë pajisjet digjitale për kontrollin e mikroklimës në mjedise të mbrojtura.
- të instalojë pajisjet digjitale për monitorimin dhe kontrollin e temperaturës, lagështisë së ajrit e të tokës në mjedise të mbrojtura.
- të instalojë pajisjet digjitale për kontrollin e parametrave agrometeorologjikë.
- të instalojë pajisjet digjitale për kontrollin e mikroklimës në stallë.
- të instalojë pajisje digjitale për kontrollin e kafshëve në kullotë.
- të instalojë pajisje digjitale për mjeljen e qumështit.
- të instalojë pajisje digjitale për drejtimin e makinerive bujqësore.
- të instalojë pajisje digjitale (sensorë) në magazine për kontrollin e temperaturës, lagështisë së ajrit për ruajtjen e prodhimit.
- të instalojë pajisje digjitale për promocionin e produkteve të fermës.
- të shkarkojë programe digjitale të thjeshta sipas nevojave dhe fushave të përdorimit të tyre.
- të instalojë programe (database) të thjeshta për grumbullimin dhe përpunimin e informacionit digjital.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë instalimit të mjeteve digjitale që përdoren në bujqësi.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë instalimit të mjeteve digjitale që përdoren në bujqësi.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi/ja përdor mjetet digjitale në bujqësi sipas

sektorëve dhe proceseve të prodhimit bujqësor.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të përdorë programe digjitale të thjeshta për informacionin e tokës bujqësore.
- të përdorë pajisjet digjitale për kontrollin në distancë të sistemeve për ujitjen efikase të bimëve.
- të përdorë pajisjet digjitale për monitorimin e dëmtuesve të bimëve.
- të përdorë pajisjet digjitale për plehërimin e bimëve.
- të përdorë pajisjet digjitale për kontrollin dhe monitorimin e parametrave agrometeorologjikë.
- të përdorë pajisjet digjitale për kontrollin e parametrave mikroklimatikë në mjedise të mbrojtura.
- të përdorë pajisjet digjitale për monitorimin e temperaturës, lagështisë së ajrit e të tokës në mjedise të mbrojtura.
- të përdorë pajisjet digjitale për kontrollin e parametrave mikroklimatikë në stallë.
- të përdorë pajisjet digjitale për kontrollin e vend-ndodhjes së kafshëve në kullotë.
- të përdorë pajisjet e automatizuara për ushqyerjen dhe matjen e parametrave shëndetësore të kafshëve.
- të përdorë pajisje digjitale për mjeljen e qumështit.
- të përdorë pajisje digjitale digjitale për drejtimin e automatizuar të makinerive bujqësore.
- të përdorë pajisje digjitale në magazine për kontrollin e temperaturës, lagështisë së ajrit për ruajtjen e prodhimit.
- të përdorë pajisje digjitale për për promovimin e produkteve të fermës.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë përdorimit të mjeteve digjitale në bujqësi sipas sektorëve dhe proceseve të prodhimit bujqësor.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të mjeteve digjitale në bujqësi sipas sektorëve dhe proceseve të prodhimit bujqësor.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi/ja përdor informacionin digjital për të drejtuar proceset bujqësore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të grumbullojë gjithë informacionin digjital në fermë në database të caktuar.
- të përpunojë informacionin digjital në funksion të proceseve prodhuese.

- të përpunojë informacionin digjital për menaxhimin e tokës bujqësore.
- të përpunojë informacionin digjital për menaxhimin efikas të ujitjes së bimëve.
- të përpunojë informacionin digjital për dëmtuesit e bimëve dhe kontrollin e tyre.
- të përpunojë informacionin digjital për plehërimin e bimëve dhe kontrollin e tij.
- të përpunojë informacionin digjital për parametrat mikroklimatikë në serra dhe kontrollin e tyre.
- të përpunojë informacionin digjital për temperaturën, lagështinë e ajrit e të tokës në ambiente të mbrojtura dhe kontrollin e tyre.
- të përpunojë informacionin digjital për parametrat mikroklimatikë në stalla dhe kontrollin e tyre.
- të përpunojë informacionin digjital për gjendjen e kafshëve në kullotë dhe kontrollin e tyre.
- të përpunojë informacionin digjital për mjeljen e qumështit dhe kontrollin e procesit.
- të përpunojë informacionin digjital dhe të drejtojë makineritë bujqësore.
- të përpunojë informacionin digjital për kontrollin e temperaturës, lagështisë së ajrit në dhomave frigoriferike, magazine dhe paisje për ruajtjen e produktit.
- të përpunojë informacionin digjital dhe të promovojë produktet në fermë.
- të përpunojë informacionin digjital me programe digjitale të thjeshta sipas nevojave dhe fushave të përdorimit të tyre.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë grumbullimit dhe përpunimit dhe përdorimit të informacionit digjital për të drejtuar proceset bujqësore.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë grumbullimit dhe përpunimit dhe përdorimit të informacionit digjital për të drejtuar proceset bujqësore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi/ja kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për përdorimin e digjitalizimit për menaxhimin e fermës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të përgatisë fletë kërkesën për bazë materiale.
- të njehsojnë kostot për përdorimin e mjeteve digjitale për menaxhimin e fermës.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.

- të njehsojnë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në përdorimin e mjeteve digjitale për menaxhimin e fermës.
- të plotësojnë dokumentacionin teknik gjatë përdorimit të mjeteve digjitale për menaxhimin e fermës.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me përdorimin e mjeteve digjitale dhe aplikacioneve.
- të llogarisë koston e përdorimit të mjeteve digjitale dhe aplikacioneve.
- të plotësojnë dokumentacionin teknik gjatë përdorimit të mjeteve digjitale dhe aplikacioneve për menaxhimin e fermës.
- të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e bazës prodhuese të shkollës (fushë e hapur, serra dhe stalla), në ekonomi bujqësore ku kultivohen bimët dhe mbarështrohen kafshët.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë që të jetë e mundur demonstrimet konkrete për instalimin e paisjeve dhe aplikacioneve digjitale të thjeshta në bujqësi.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për kryerjen e një sërë operacionesh pune për instalimin e paisjeve dhe aplikacioneve digjitale të thjeshta, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas të pavarur.
- Nxënësit, nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës të paisjeve digjitale dhe rëndësinë e kryerjes së tyre.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për instalimin dhe përdorimin e paisjeve digjitale dhe aplikacioneve sipas proceseve të punës.
- Mësimdhënësi mund të organizojë vizita mësimore në kultivues të suksesshëm dhe ferma që kultivojnë dhe që kanë instaluar e përdorin mjetet digjitale dhe aplikacionet në bujqësi.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjetet e mëposhtme:
- Mjete e paisje digjitale që përdoren në bujqësi.
 - Kompjuter, Lap Top, Smartphonë, Sensorë.
 - Manuale, katalogë, udhëzues, etj.
 - Aplikacione digjitale, softëare etj.

5. Moduli “Trajtimi i kafshëve për prodhim qumështi e mishi”

Kualifikimi: Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	TRAJTIMI I KAFSHËVE PËR PRODHIM QUMËSHTI E MISHI	M-28-1597-24
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për trajtimin e kafshëve në periudhën e laktacionit dhe trajtimin e kafshëve për mish, si dhe për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me trajtimin e kafshëve për prodhim qumështi e mishi.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin profesional “Bujqësi”, Niveli II në KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi/ja trajton lopët në periudhën e laktacionit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë: – të përgatisë uniformën për kryerjen e shërbimeve në stallë. – të përzgjedhë stalla me hapësirë të mjaftueshme për qëndrimin dhe lëvizjen e lopëve. – të largojë në kohën e duhur plehun nga stalla. – të pastrojë dhe dezinfektojë vendqëndrimin e kafshës. – të sigurojë temperaturën dhe ajrimin normal të mjedisit në stallë. – të kryejë pastrimin e lëkurës së trupit të kafshës sipas teknikës përkatëse. – të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet që përdoren për pastrimin e trupit të lopëve – të realizojë pastrimin dhe ruajtjen e higjienës së trupit të lopëve. – të përzgjedhë mjetet e nevojshme për ushqyerjen e lopëve. – të përlllogaritë sasinë e qumështit që do të prodhohet nga çdo lope në laktacion. – të përzgjedhë ushqimet për lopët në laktacion. – të hartojë dhe përgatitë racionin ushqimor, sipas fazave të laktacionit. – të bëjë ndarjen racionale e ushqimit për lopë. – të hedhë me kujdes ushqimin në grazhdë. – të përgatitë lopët për mjelje sipas kushteve higjieno-	

sanitare.

- të realizojë mjeljen me dorë ose në mënyrë mekanike sipas mundësive.
- të grumbullojë në enë të posaçme qumështit e mjelë.
- të paketojë qumështin e grumbulluar për treg sipas kërkesës.
- të ruajë në kushte të caktuara higjieno-sanitare qumështin e grumbulluar.
- të regjistrojë të dhënat e duhura, në kartelën përkatëse, për çdo lopë.
- të pastrojë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet që përdoren për pastrimin e lopëve dhe ambjentit të tyre.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së ambjentit gjatë trajtimit të lopëve në laktacion.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi/ja trajton delet e dhitë gjatë periudhës së laktacionit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë uniformën dhe veglat e nevojshme të punës për trajtimin e deleve e dhive në laktacion.
- të përllogaritë sasinë e ushqimit kundrejt numrit të kafshëve që mbarështohen.
- të përcaktojë llojshmërinë e ushqimeve që do të përdoren për trajtimin e kafshëve në laktacion sipas nevojës së kafshës në regjimin stallor si: hasëlle, bar i thatë, gjethe dushku, silazh, koncentrat, etj.
- të përgatisë racionin ushqimor për dhentë e dhitë në laktacion sipas prodhimit të qumështit
- të ushqejë kafshët në stalla, sipas vakteve të caktuara.
- të përgatisë mjedisin për ushqyerjen e kafshëve në kullotje të lirë.
- të realizojë kullotjen e lire të deleve dhe dhive në periudhën e laktacionit.
- të kujdeset për qengjat dhe kecat gjatë pirjes së kulloshtres dhe qumështit tek nënat, në sasinë dhe kohën e duhur.
- të shkëputë qengjat dhe kecat nga nënat, në kohën e duhur.
- të kontrollojë peshën trupore të qengjave e kecape dhe kohën e shkëputjes nga nëna.
- të kujdeset vazhdimisht për higjienën e gjirit në dele e dhi, si: pastrimin, larjen dhe masazhimin e gjirit.
- të mjelë delet dhe dhitë sipas kohës së përcaktuar.
- të shënojë saktë sasisë e qumështit të mjelë, në kartelën përkatëse.

- të grumbullojë qumështin e mjelë në enë të posaçme.
- të paketojë qumështin për treg, sipas kërkesës.
- të ruajë qumështin në kushtet e duhura higjiono-sanitare.
- të regjistrojë saktë të dhënat në kartelën përkatëse.
- të pastrojë dhe mirëmbajë mjetet e pajisjet që përdorën gjatë trajtimit të deleve e dhive në periudhën e laktacionit.
- të përcaktojë dhe përgatisë territorin e duhur për kullotjen e deleve ose dhive.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve dhe trajtimit të deleve e dhive. gjatë laktacionit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi/ja trajton viçat për majmëri.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- Të përgatisë e të veshë uniformën për trajtimin e viçave për majmëri.
- Të përzgjedhë ambjentin e përshtatshëm për viçat e majmërisë
- Të përzgjedhë veglat dhe paisjet për kryerjen e shërbimeve në stallë.
- Të sigurojë mikroklimën në stallë sipas standardit të kërkuar.
- Të sigurojë kushtet higjenike në stallë, sipas standardit të kërkuar.
- Të përzgjedhë viçat për majmëri, sipas kriterëve të duhura.
- Të përzgjedhë veglat e duhura për ushqyerjen e viçave.
- Të përlllogarisë sasinë e ushqimeve për numrin e caktuar të viçave për majmëri.
- Të përzgjedhë saktë llojet e ushqimeve për trajtimin e viçave për majmëri.
- Të hartojë racionin ushqimor sipas grup moshave.
- Të bëjë ndarjen racionale të ushqimit kokë për kokë.
- Të kryejë hedhjen e ushqimit në grazhd.
- Të sigurojë sasinë e ujin të pijshëm të nevojshëm për viçat në majmëri.
- Të regjistrojë të dhënat e duhura në kartelën përkatëse për sejcilin viç.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të zbatojë drejtë masat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për trajtimin e viçave për majmëri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi/ja trajton derrat për majmëri.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- Të përgatisë e të veshë uniformën për trajtimin e derrave për majmëri.
- Të përzgjedhë ambientin e përshtatshëm për derrat e majmërisë
- Të përzgjedhë veglat dhe paisjet për kryerjen e shëbimeve në stallë.
- Të sigurojë kushtet higjenike dhe mikroklimën në stallë sipas standardit të kërkuar.
- Të përzgjedhë derrat për majmëri, sipas kriterëve të duhura.
- Të përzgjedhë veglat e duhura për ushqyerjen e derrave.
- Të përllogarisë sasinë e ushqimeve për numrin e caktuar të derrave për majmëri.
- Të përzgjedhë saktë llojet e ushqimeve për trajtimin e derrave për majmëri.
- Të përllogarisë sasinë e nevojshme të ushqimeve për trajtimin e derrave për majmëri.
- Të hartojë racionin ushqimor sipas grup moshave.
- Të bëjë ndarjen racionale të ushqimit kokë për kokë.
- Të sigurojë sasinë e ujin të doemosdoshëm të pishëm për derrat në majmëri.
- Të regjistrojë të dhënat e duhura në kartelën përkatëse për sejcilin derr.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të zbatojë drejtë masat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për trajtimin e derrave për majmëri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi/ja trajton shpendët për mish dhe vezë.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse për trajtimin e shpendëve për mish dhe vezë.
- Të përzgjedhë ambientin e përshtatshëm të shpendëve për mish dhe vezë.
- Të përzgjedhë veglat dhe pajisjet për kryerjen e shërbimeve në komplekset/ stallet e shpendëve.
- Të sigurojë mikroklimën në stallë sipas standardit të kërkuar për shpendët për mish.
- Të sigurojë mikroklimën në stallë sipas standardit të kërkuar për shpendët për vezë.
- Të sigurojë kushtet higjenike në stallë, sipas standardit të kërkuar.
- Të përzgjedhë linjat e shpendëve për mish, sipas kriterëve të duhura.
- Të përzgjedhë linjat e shpendëve për vezë, sipas kriterëve të

duhura.

- Të përzgjedhë veglat e duhura për ushqyerjen e shpendëve për mish dhe vezë.
- Të përllogarisë sasinë e ushqimeve për numrin e caktuar të shpendëve për mish.
- Të përllogarisë sasinë e ushqimeve për numrin e caktuar të shpendëve për vezë.
- Të përzgjedhë saktë llojet e ushqimeve për trajtimin e shpendëve për mish.
- Të përzgjedhë saktë llojet e ushqimeve për trajtimin e shpendëve për vezë.
- Të hartojë racionin ushqimor sipas grup moshave të shpendëve.
- Të bëjë ndarjen racionale të ushqimit për trajtimin e shpendëve për mish.
- Të kryejë hedhjen e ushqimit në në enë ose sillos.
- Të sigurojë sasinë e ujin të pijshëm të nevojshëm për shpendët për mish dhe vezë.
- Të rregjistrojë të dhënat e duhura në kartelën përkatëse për shpendët.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të zbatojë drejt masat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për trajtimin e shpendëve për mish dhe vezë.

RN 6 Nxënësi/ja kryen llogaritje të thjeshta ekonomike të trajtimit të kafshëve për prodhim qumështi e mishi.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të përgatisë fletë kërkesën për bazë materiale.
- të njehsojë kostot në trajtimin e kafshëve të qumështit dhe mishit, si dhe përbërësit e kostove, sipas manualit përkatës.
- të njehsojë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojë kostot e tjera (transport, amortizime dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për trajtimin e kafshëve të qumështit dhe mishit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në territorin e fermës së shkollës dhe territore të tjera të përshtatshme pranë shkollës.
- Mësimdhënësi mund të organizojë edhe vizita në ferma blegtorale të cilat mbarështojnë lopë, dele e dhi me regjim stallor dhe kullosor dhe që janë në periudhën e laktacionit, në rastet e trajtimit të

kafshëve për mish (viça e derra), shpendët për mish dhe vezë, si dhe për llogaritjet e thjeshta ekonomike që lidhen me trajtimin e kafshëve të qumështit dhe mishit.

- Mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të punëve që kryhen për trajtimin e kafshëve gjatë periudhës së laktacionit dhe trajtimit të kafshëve për mish, trajtimit të shpendëve për mish dhe vezë, në bazën prodhuese të shkollës dhe ekonomi blegtorale, si dhe kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me trajtimin e kafshëve të qumështit dhe mishit.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë tekste standarde dhe manuale që kanë të bëjnë me metodat e trajtimit të kafshëve në laktacion e majmëri dhe të trajtimit të shpendëve për mish dhe vezë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune në fermën e shkollës dhe ambjente të tjera të përshtatshme për trajtimin e kafshëve në periudha të ndryshme të laktacionit e të majmërisë, shpendëve për mish dhe vezë, llogaritjet e thjeshta ekonomike që lidhen me trajtimin e kafshëve të qumështit dhe mishit, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për njohuritë e marra për trajtimin e kafshëve të qumështit dhe të majmërisë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Baza prodhuese ose fermë për rritjen e kafshëve dhe shpendëve.
 - Pajisje dhe vegla pune për pastrimin e stallës dhe trupit të kafshëve.
 - Furça, sfungjerë, kashai, thika druri, bigerina.
 - Peshqirë, pece, kova uji për higjienën e gjirit.
 - Aparat për mjelje mekanike.
 - Bidonë apo tank ftohës për ruajtjen e qumështit.
 - Tokë kullosore, magazinë ushqimi, depo silazhi.
 - Tabela analitike të ushqimeve. Tabela për nevojat ushqimore të kafshëve.
 - Mjete të tjera vizuale, materiale studimore.
 - Video me demonstrime të ndryshme. Pajisje kancelarie, makina llogaritëse dore.
 - Manuallet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e blegtorisë (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal
-

XI. Programi orientues i provimeve përfundimtare të nivelit.

Programi orientues për provimet përfundimtare të kualifikimin profesional "Ferma bujqësore dhe blegtorale", Niveli III i KSHK, përmban temat dhe kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë profil mësimor, të trajtuara në lëndët profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e këtij niveli, të cilat do të shërbejnë si bazë për të konceptuar provimet teorike dhe praktike përkatëse.

Ky program i ndihmon nxënësit të përqëndrohen në ato njohuri (koncepte, parime, ligjësi, procedura etj.) dhe kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësuesit për organizimin e punës në përgatitjen për kontrollin përfundimtar të arritjeve të nxënësve.

Për drejtuesit e shkollave profesionale, këto programe krijojnë mundësinë për planifikimin dhe realizimin e Provimeve Përfundimtare në nivel shkolle.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t'i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e nxënësit/es në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në nivelin tjetër.

Gjatë përgatitjes së nxënësve për provimet përfundimtare të niveleve, është e rëndësishme që paraprakisht mësuesit/instruktorët të zhvillojnë teste të nxënësve, me teste teorike apo praktike, të cilat mund t'i hartojnë vetë, duke përdorur instrumente vlerësimi në përputhje me kërkesat e këtij dokumenti. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh njohuritë dhe kompetencat e përfshira në këtë program, kriteret e vlerësimit të përcaktuara në modulet përkatëse si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

Programi orientues përbëhet nga dy pjesë:

- Programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar;
- Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar.

A) Programi orientues për Provimin e Teorisë Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar, në kualifikimin profesional "Ferma bujqësore dhe blegtorale", është hartuar duke u mbështetur në temat më të rëndësishme të programeve të lëndëve profesionale më përfaqësuese dhe më thelbësore, të cilat përbëjnë 30-35% të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

Lëndët profesionale të përzgjedhura për t'u përfshirë në provimin e teorisë profesionale dhe temat e përzgjedhura, janë si më poshtë.

Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues:

Nr.	Lënda	Vëllimi i orëve për lëndën	Peshat në %
1	Teknologjia e prodhimit bimor	46	52
2	Teknologjia e prodhimit blegtoral	32	36
3	Përpunimi i prodhimit bimor dhe blegtoral	11	12
	TOTALI	89	100%

Temat sipas lëndëve janë:

Temat nga lënda “Teknologjia e prodhimit bimor”, kl. 12 :

46 orë

Tema 5	Rëndësia, llojet e plehrave dhe plehërimi i tokës në prodhimin bimor	4 orë
Tema 6	Përzgjedhja dhe kontrolli i cilësisë së materialit mbjellës bimor	4 orë
Tema 7	Teknologjitë e prodhimit të fidanëve	4 orë
Tema 8	Teknologjitë e kultivimit të bimëve të arave	4 orë
Tema 9	Teknologjinë e kultivimit të perimeve	8 orë
Tema 10	Teknologjinë e kultivimit të kulturave foragjere	4 orë
Tema 11	Teknologjinë e kultivimit të kulturave drufrutore	3 orë
Tema 12	Shërbimet agroteknike dhe kontrolli digjital i dëmtuesve në bujqësi	6 orë
Tema 13	Teknologjitë e prodhimit biologjik në prodhimin bimor	4 orë
Tema 14	Vjelja/korrja/kositja e kulturave bujqësore dhe platformat digjitale për monitorimin e kohës së vjeljes	5 orë

Temat nga lënda “Teknologjia e prodhimit blegtoral”, kl. 12:

32 orë

Tema 4	Teknologjitë e të ushqyerit të kafshëve dhe shpendëve të fermës. Parandalimi i kontaminimit të ushqimeve.	12 orë
Tema 7	Sigurimi i higjienës në fermën blegtorale	7 orë
Tema 10	Përpunimi i plehut, kompostimi i mbetjeve organike dhe mënyrat e riciklimit të mbetjeve në fermë.	4 orë
Tema 13	Kujdesi dhe trajtimi i kafshëve gjatë dhe pas pjelljes.	4 orë
Tema 14	Burimet e infeksionit të kafshët dhe shpendët dhe masat sanitorio-veterinare.	5 orë

Temat nga lënda “Përpunimi i prodhimit bimor dhe blegtoral”, kl. 12:

11 orë

Tema 1	Rëndësia e përpunimit dhe e ruajtjes të prodhimeve bimore dhe blegtorale	2 orë
Tema 3	Përpunimi dhe ruajtja e rrushit	4 orë
Tema 7	Përpunimi dhe ruajtja e qumështit	5 orë

Udhëzime për përgatitjen e testit të provimit të teorisë profesionale:

Provimi i teorisë profesionale të integruar do të jetë me test me shkrim, i cili zgjat 1.5 (një presje pesë) dhe përgatitet nga Komisioni i Provimit Përfundimtar i kualifikimit të nivelit përkatës. Për hartimin e testit, komisioni mund të mbështetet edhe tek banka e testeve e përgatitur nga AKAFPK-ja. Në hartimin e testit komisioni duhet të mbajë parasysh rregullat, parimet dhe formatet, për ndërtimin e testit.

Testi duhet të përmbajë 20 njësi testi me një total prej 40 pikë. Nga këto, 10 njësi testi të jenë me zgjedhje të shumëfishtë (4 alternativa) dhe 10 të tjerat të jenë njësi testi me përgjigje të kufizuara/të mbyllura (me PO/JO; me e Vërtetë e Gabuar; me plotësim të fjalës që mungon; etj.) Testi duhet të shmang pyetjet e hapura.

Njësitë e testit duhet të jenë të niveleve të ndryshme të vështirësisë, duke ndjekur skemën me tri nivele, si më poshtë:

Model i shpërndarjes së pikëve për pyetje të niveleve të ndryshme në test

Niveli I (i ulët)	Niveli II (mesatar)	Niveli III (i lartë)
Aftësia për të rikujtuar/kuptuar/identifikuar dhe për të përshkruar...	Aftësia për të zbatuar/argumentuar/shpjeguar/krahasuar dhe për të analizuar...	Aftësia për të vlerësuar dhe për të nxjerrë përfundime...

Tabela 2: Ndarja e pikëve sipas peshës së çdo lënde dhe niveleve

Nr.	Lënda	Peshat e lëndëve në %	Pikët për çdo lëndë	Ndarja e pikëve sipas niveleve të vështirësisë		
				Niveli I 40% e pikëve	Niveli II 40% e pikëve	Niveli III 20% e pikëve
1	Teknologjia e prodhimit bimor	52	21	8	8	5
2	Teknologjia e prodhimit blegtoral	36	14	6	6	2
3	Përpunimi i prodhimit bimor dhe blegtoral	12	5	2	2	1
TOTALI		100%	40 pikë	16 pikë	16 pikë	8 pikë

Përcaktimi i pikëve për çdo njësi testi bëhet duke pasur parasysh tipin e njësive të testit. Për shembull: njësitë e testit me zgjedhje të shumëfishtë marrin gjithmonë 1 (një) pikë përkundrejt përgjigjes së paracaktuar të saktë; njësitë me përgjigje të hapur marrin aq pikë sa kërkesa kanë brenda tyre (duke mbajtur parasysh edhe argumentimin nga nxënësi); njësitë me përgjigje të kufizuara marrin aq pikë sa gjykohet nga grupi hartues dhe kjo lidhet me kërkesat që parashtrihen në pyetje dhe niveli i vështirësisë.

Së fundi, skema e vendosjes së notës kundrejt pikëve të fituara përcaktohet nga grupi hartues i testit. Në vijim, jepet një model i skemës së vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 10	4
11 - 15	5
16 - 20	6
21 - 25	7
26 - 30	8
31 - 35	9
36 - 40	10

B) Programi orientues për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në kualifikimin profesional "Ferma bujqësore dhe blegtorale" Niveli III në KSHK, është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, detyrat e punës dhe pikët për secilën kompetencë:

Nr	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1.	Të prodhojë fidanë drufrutore.	Detyra 1 - Realizimi i një prej proceseve të punës për prodhimin e kulturave drufrutore: sigurimi i copave për nënshartesa, shartime me syth/kalema, shërbime në shartesore (plehërimi i tokës në pemëtore, punimi i tokës, ujitja, krasitja e pemëve, spërkatjen), klasifikimin, etiketimin dhe ruajtjen e fidanëve të shartuar.	20
2	Të kryejë trajtimin kimik të kulturave të fermës.	Detyra 2 - Realizimi i një prej proceseve të punës për trajtimin kimik të kulturave të fermës: përgatitja e tretësirës për trajtim, trajtimi kimikisht i bimëve të infektuara sipas kulturave rajonale.	20
3	Të mirëmbajë rrjetit kullues-ujitës në fermë.	Detyra 3 - Realizimi i një prej proceseve të ngritjes së rrjetit kullues dhe ujitës të fermës: mirëmbajtjen e kanaleve të treta kulluese (K ₃ K); hapjen dhe mirëmbajtjen e vijave kulluese; mirëmbajtjen e kanaleve të treta ujitëse (K ₃ U); hapjen dhe mirëmbajtjen e vijave ujitëse;	20

4.	Të kryejë përpunimin e prodhimeve bimore dhe blegtorale të fermës.	Detyra 4 - Realizimi i një prej proceseve të përpunimit të prodhimeve bimore dhe të fermës: përpunimi i drithërave për miell, frutave për lëng, komposto reçel etj., perimeve për marinada dhe turshi, qumështin për konsum dhe nënprodukte, mishit për konsum.	20
5	Të realizojë përkujdesje për mirëqënien dhe shëndetin kafshëve.	Detyra 5 - Realizimi i një prej përkujdesjeve të kafshëve bujqësore: përgatitja e akomodimit të përshtatshëm për mirëqënien e kafshës, të ushqyerit e kafshëve lidhur me mirëqënien e tyre, kujdesit për shëndetin e kafshës.	10
6	Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike në fermat bujqësore dhe blegtorale.	Detyra 6- Realizimi i llogaritjeve të thjeshta ekonomike në fermat bujqësore dhe blegtorale: llogaritjen e preventivit të shpenzimeve, llogaritjen e kostos për njësi, llogaritjen e çmimit për njësi, plotëson faturën e shitjes së produktit të realizuar në detyrat e mësipërme.	10
Shuma			100

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve në “detyra pune”, në fermën bujqësoredhe blegtorale të shkollës ose ferma reale afër shkollës.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 (tri) orë, në përputhje kjo me Udhëzimin nr. 15. Datë 26.04.2019 “ Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në arsimin dhe formimin profesional”, në fuqi.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t’i lihet hapësirë për vlerësime edhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara.
- Është *e domosdoshme dhe shumë e rëndësishme* që për çdo detyrë, që në fillim të provimit të praktikës profesionale, nga mësimdhënesit (organizatorët e provimit) t’i kushtohet vëmendje *“përcaktimit dhe zbatimit të rregullave të sigurimit teknik, të ruajtjes së mjedisit dhe mbrojtjes së shëndetit”* gjatë gjithë kryerjes së detyrës për çdo nxënësi.
- Në çdo detyrë respektimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit duhet të jenë domosdoshmërisht të përfshira në vlerësim.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj, duke filluar nga përgatitja e vendit, mjeteve dhe pajisjeve të punës, etj.
- Gjithashtu për çdo detyrë komisioni duhet të përfshijë në vlerësim një element shumë të rëndësishëm, i cili është sistemimi dhe pastrimi i vendit, i mjeteve dhe pajisjeve të punës pasi nxënësi ka realizuar dhe përfunduar detyrën.

- Për realizimin e detyrave, nxënësve duhet t'u sigurohen mjete, pajisjet si dhe materialet për realizimin e tyre.
- Nxënësit duhet të realizojnë të gjitha etapat për realizimin e detyrave.
- Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme si dhe komunikimi, bashkëpunimi në grup, bashkëveprimi ndërmjet njëri - tjetrit etj.
- Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi për çdo detyrë.
- Komisioni i provimit për çdo detyrë parapërgatit tezat e provimit ku nxënësi në mënyrë të rastësishme zgjedh njërën prej tyre. Komisioni i provimit duhet të përgatitë paraprakisht instrumentin e vlerësimit me procedurat/hapat/etapat e kryerjes së detyrave. Komisioni nuk duhet të ndërhyjë gjatë zhvillimit të provimit.
- Vlerësimi i të gjitha detyrave bëhet me listë kontrolli në bazë të instrumenteve përkatëse të vlerësimit.

Udhëzime për realizimin e **Detyrës 1** : Nxënësi kryen procese pune për prodhimin e fidanëve drufrutore.

Kjo detyrë do të realizohet në mjediset e bazës prodhuese të shkollës apo në ferma reale afër shkollës.

Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë procese pune që lidhen me prodhimin e kulturave drufrutore si: sigurimi i copave për nënshartesa, shartime me syth/kalema, shërbime në shartesore (plehërimi i tokës në pemëtore, punimi i tokës, ujitja, krasitja e pemëve, spërkatjen), klasifikimin, etiketimin dhe ruajtjen e fidanëve të shartuar.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë etapat e proceseve të punës që lidhen me: sigurimi i copave për nënshartesa, shartime me syth/kalema, shërbime në shartesore (plehërimi i tokës në pemëtore, punimi i tokës, ujitja, krasitja e pemëve, spërkatjen), klasifikimin, etiketimin dhe ruajtjen e fidanëve të shartuar dhe zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, sipas tezës, duke përdorur mjetet dhe pajisjet e punës sipas procesit.

Në fund të procesit të punës nxënësi duhet t'a prezantojë atë duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale, të inventarizojë mjetet dhe pajisjet e përdorura si dhe të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve.
- Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e detyrës.
- Materiale si fara, copa ose sharmenda hardhie, mastiç, sytha, lidhëse, plehëra organike dhe minerale, pesticide, qese etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

Udhëzime për realizimin e **Detyrës 2**, Nxënësi kryen trajtimin kimik të kulturat e fermës. Kjo detyrë do të realizohet në mjediset e bazës prodhuese të shkollës apo në fermat reale afër shkollës.

Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë procese pune që

lidhen me shërbimet në kulturat e fermës bujqësore si: përgatitja e tretësirave për trajtim, trajtimin kimik të bimëve të infektuara sipas kulturave rajonale.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë etapat e proceseve të shërbimeve në kulturat e fermës bujqësore si: përgatitja e tretësirave për trajtim, trajtimin kimik të bimëve të infektuara sipas kulturave rajonale si dhe vendosjen e tabelave paralajmëruese për rezikun nga helmimi dhe zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, sipas tezës, duke përdorur mjetet dhe pajisjet e punës sipas procesit.

Në fund të procesit të punës të shërbimeve në kulturat e fermës bujqësore nxënësi duhet t'a prezantojë atë duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale, të inventarizojë mjetet dhe pajisjet e përdorura si dhe të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve.
- Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e detyrës.
- Materiale si plehëra organike dhe minerale, pesticide, tub uji etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

Udhëzime për realizimin e **Detyrës 3**, Nxënësi kryen procese të mirëmbajtjes së rrjetit kullues-ujitës në fermë.

Kjo detyrë do të realizohet në mjediset e bazës prodhuese të shkollës.

Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë procese pune që lidhen me mirëmbajtjen e kanaleve të treta kulluese (K_3K); hapjen dhe mirëmbajtjen e vijave kulluese; mirëmbajtjen e kanaleve të treta ujitëse (K_3U); hapjen dhe mirëmbajtjen e vijave ujitëse Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë procese pune që lidhen me ngritjen e rrjetit kullues dhe sistemimin e tokës në fermë si: mirëmbajtjen e kanaleve të treta kulluese (K_3K); hapjen dhe mirëmbajtjen e vijave kulluese; mirëmbajtjen e kanaleve të treta ujitëse (K_3U); hapjen dhe mirëmbajtjen e vijave ujitëse dhe zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, sipas tezës, duke përdorur mjetet dhe pajisjet e punës sipas procesit.

Në fund të procesit të punës që lidhen me gritjen e rrjetit kullues dhe sistemimin e tokës në fermë nxënësi duhet t'a prezantojë atë duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale, të inventarizojë mjetet dhe pajisjet e përdorura si dhe të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve.
- Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e detyrës.
- Materiale si piketa, spango, metër shirit etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

Udhëzime për realizimin e **Detyrës 4**. Nxënësi kryen procese të ndryshme përpunimi të prodhimeve bimore dhe blegtorale të fermës.

Kjo detyrë do të realizohet në repartin e përpunimit të produkteve bujqësore e blegtorale ose në mjedise të shkollës të përshtatur dhe të pajisur me mjetet përkatëse.

Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë procese të përpunimit të prodhimeve bimore dhe blegtorale të fermës si përpunimi i drithërave për miell, frutave për lëng, komposto reçel etj., perimeve për marinada dhe turshi, qumështin për konsum dhe nënprodukte, mishit për konsum.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë procese përpunimi të prodhimeve bimore dhe blegtorale si: përpunimi i drithërave për miell, frutave për lëng, komposto reçel etj., perimeve për marinada dhe turshi, qumështin për konsum dhe nënprodukte, mishit për konsum, sipas rajonit dhe zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, sipas tezës, duke përdorur mjetet dhe pajisjet e punës sipas procesit.

Në fund të procesit të përpunimit të produkteve bujqësore e blegtorale nxënësi duhet t'a prezantojë atë duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale, të inventarizojë mjetet dhe pajisjet e përdorura si dhe të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve të përpunimit të frutave.
- Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e detyrës.
- Materiale ambalazhuese sipas llojit të përpunimit prodhimeve bimore dhe blegtorale.

Nxënësi angazhohet në veprimtari praktike konkrete të tilla si: përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës, higjienizimi i vendit dhe mjeteve të punës dhe kryen njërin prej përpunimeve të prodhimeve bimore dhe blegtorale.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

Udhëzime për realizimin e **Detyrës 5**. Nxënësi kryen përkujdesje për mirëqenien dhe shëndetin e kafshëve.

Kjo detyrë do të realizohet në mjediset e bazës prodhuese të shkollës ose në fermë ku rriten kafshë.

Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë përkujdesje për përkujdesjeve të kafshëve bujqësore: përgatitja e akomodimit të përshtatshëm për mirëqenien e kafshës, të ushqyerit e kafshëve lidhur me mirëqenien e tyre, kujdesit për shëndetin e kafshës.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë etapat e një prej përkujdesjeve të kafshëve bujqësore si: për mirëqenien dhe shëndetin e kafshëve bujqësore dhe zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik, higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit, sipas tezës, duke përdorur mjetet dhe pajisjet e punës sipas procesit.

Në fund të procesit të punës nxënësi duhet t'a prezantojë atë duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale, të inventarizojë mjetet dhe pajisjet e përdorura si dhe të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve.
- Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e detyrës.
- Materiale si ushqime të ndryshme, barë i njomë, barë i thatë, drithëra, koncentre, katalogë ushqimesh etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

Udhëzime për realizimin e **Detyrës 6**. Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike nxëfermat bujqësore dhe blegtorale.

Kjo detyrë do të realizohet në mjediset e firmës ushtrimore/biznese reale të profilit përkatës ose mjedise të shkollës të përshtature dhe të pajisura me mjetet përkatëse. Detyra do të kryhet në mënyrë individuale nga çdo nxënësi. Komisioni i provimit do të përgatisë paraprakisht disa teza, ku secila prej tyre do të përmbajë situata të ndryshme të llogaritjes së preventivit të shpenzimeve, të llogaritjes së kostos për njësi, çmimit për njësi prodhimi për produktin të realizuar në detyrat e mësipërme. Krahas llogaritjeve ekonomike, nxënësi duhet të plotësojë edhe faturën e shitjes së produktit bujqësor/blegtoral. Në vijim duhet të organizohet një lojë me role në një situatë simulimi të shitjes së produkteve të përgaditura në detyrat e mësipërme.

Nxënësi angazhohet në veprimtari praktike konkrete të tilla si: përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës, llogaritje të thjeshta ekonomike si dhe të plotësimit të dokumentacionit përkatës. Për realizimin e kësaj detyre, instruktori, komisioni duhet të sigurojë, mjediset, paisjet dhe materialet e mëposhtme: mjedise të firmës ushtrimore/biznes, kompjuter, fotokopje, shërbime interneti, programe kompjuterike, materiale udhëzuese të shkruara, pajisje kancelarie, makina llogaritëse dore, manualët e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos, modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal, etj. Komisioni i provimit të përgatisë paraprakisht instrumentet e vlerësimit me hapat/etapat e procesit. Komisioni nuk duhet të ndërhyjë gjatë zhvillimit të provimit. Vlerësimi i kësaj detyre bëhet me pikë në bazë të përmbushjes së gjithë proceseve të përfshira në tezën përkatëse të çdo nxënësi, si dhe në bazë të instrumentit të vlerësimit përkatës. Komisioni i provimit përgatit paraprakisht instrumentin e vlerësimit, i cili do të jetë një listë kontrolli dhe lista e kritereve të vlerësimit me tolerancën përkatëse për cilësinë e shërbimit. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

Secili nga postet e punës së lartpërmendur të ketë listë vlerësimi më vehte dhe në fund të realizimit të detyrave të parashikuara, të bëhet tabela përmbledhëse e pikëve dhe të hidhet nota përkatëse. Nxënësit do të vlerësohen për realizimin e detyrave sipas listës së kontrollit.